

Mekanizmi i Raportimit të Pavarur (MRP): Raporti Përfundimtar për Shqipërinë 2016-2018

Gjergji Vurmo, Hulumtues i pavarur

Përmbledhje Ekzekutive: Shqipëria	4
Konsultimi me shoqërinë civile gjatë zbatimit	5
Rreth vlerësimit.....	6
Zbatimi i angazhimit.....	8
Përmbledhje e përgjithshme e angazhimeve	8
1. Përmirësimi i portalit për akses tek informacioni.....	10
Synimi i angazhimit	10
Zbatimi	11
A mundësoi qeverisje të hapur?	11
Hapat e mëtejshëm	11
2. Transparenca e buxhetit.....	12
Synimi i angazhimit	12
Zbatimi	13
A mundësoi qeverisje të hapur?	13
Hapat e mëtejshëm	14
3. Regjistri i integruar i banesave të shtetasve	15
Synimi i angazhimit	16
Zbatimi	16
A mundësoi qeverisje të hapur?	16
Hapat e mëtejshëm	17
4. Regjistri i njoftimeve dhe konsultimeve publike	18
Synimi i angazhimit	19
Zbatimi	19
A mundësoi qeverisje të hapur?	19
Hapat e mëtejshëm	20
5. Arkiva Dixhitale.....	21
Synimi i angazhimit	21
Zbatimi	22
A mundësoi qeverisje të hapur?	22
Hapat e mëtejshëm	22

6. Baza e të dhënave të kërkimeve shkencore	24
Synimi i angazhimit	24
Zbatimi	25
A mundësoi qeverisje të hapur?	25
Hapat e mëtejshëm	25
7. Publikimi në internet i legjislacionit të qeverisë	27
Synimi i angazhimit	27
Zbatimi	28
A mundësoi qeverisje të hapur?	28
Hapat e mëtejshëm	29
8. Regjistri elektronik i koncesioneve	30
Synimi i angazhimit	31
Zbatimi	31
A mundësoi qeverisje të hapur?	31
Hapat e mëtejshëm	32
9. Zbatimi i Ligjit për Sinjalizimet dhe Mbrojtjen e Sinjalizuesve	33
Synimi i angazhimit	34
Zbatimi	34
A mundësoi qeverisje të hapur?	35
Hapat e mëtejshëm	35
10. Ofrimi i shërbimeve elektronike	36
Synimi i angazhimit	36
Zbatimi	36
A mundësoi qeverisje të hapur?	37
Hapat e mëtejshëm	37
11. Thjeshtimi i aplikimeve për leje ndërtimi	38
Synimi i angazhimit	39
Zbatimi	39
A mundësoi qeverisje të hapur?	39
Hapat e mëtejshëm	39
12. Ngritja e sporteve dixhitale.....	40
Synimi i angazhimit	40
Zbatimi	40
A mundësoi qeverisje të hapur?	41
Hapat e mëtejshëm	41
13. Standardizimi i pasaportave të shërbimeve	42
Synimi i angazhimit	43
Zbatimi	43

A mundësoi qeverisje të hapur?	43
Hapat e mëtejshëm	43
14. Kartela informative e qytetarit	45
Synimi i angazhimit	46
Zbatimi	46
A mundësoi qeverisje të hapur?	46
Hapat e mëtejshëm	47
15. Receta elektronike pilot.....	48
Synimi i angazhimit	48
Zbatimi	49
A mundësoi qeverisje të hapur?	49
Hapat e mëtejshëm	50
16. Sistemi i monitorimit elektronik të pyjeve	51
Synimi i angazhimit	52
Zbatimi	52
A mundësoi qeverisje të hapur?	52
Hapat e mëtejshëm	52
17. Sistemi elektronik për aplikimet për licenca profesionale.....	54
Synimi i angazhimit	55
Zbatimi	55
A mundësoi qeverisje të hapur?	55
Hapat e mëtejshëm	55
Shënime për metodologjinë.....	57



Përmbledhje Ekzekutive: Shqipëria

Raporti përfundimtar për Shqipërinë nga Mekanizmi i Raportimit të Pavarur (MRP) 2016-2018

Zbatimi i Planit të tretë të Veprimit të Shqipërisë u ndikua në mënyrë të konsiderueshme nga shkrimi i Ministrisë së Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike në shtator të vitit 2017, ministri që shërbente si institucioni kryesor koordinues për Partneritetin për Qeverisje të Hapur (PQH). Më shumë se gjysma e 17 angazhimeve nuk patën ndonjë përmirësim të dukshëm në lidhje me hapjen e qeverisë. Për të arritur sukses në procesin e PQH, qeveria shqiptare duhet të ndërtojë një dialog të sqartë me shoqërinë civile dhe të mbështetet në arritjet e planeve të mëparshme të veprimit.

Partneriteti për Qeverisje të Hapur (PQH) është një nismë vullnetare ndërkombëtare që synon të sigurojë angazhime të qeverive ndaj qytetarëve për të promovuar transparencën, fuqizimin e qytetarëve, luftën kundër korrupsionit, dhe për të shfrytëzuar teknologjitë e reja për forcimin e qeverisjes. Shqipëria filloi të marrë pjesë në PQH në shtator të vitit 2011. Mekanizmi i Raportimit të Pavarur (MRP) shqyrton çdo vit aktivitetet e çdo vendi që merr pjesë në PQH.

Ky raport përmbledh rezultatet e periudhës korrik 2016 deri në qershor 2018 dhe përfshin zhvillimet përkatëse deri në shtator 2018.

Fillimisht, ishte Ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike (MIAP) institucioni kryesor që përgjigjej për angazhimet PQH të Shqipërisë. MIAP nuk kishte fuqi ligjore për të imponuar ndryshime tek agjencitë e tjera të qeverisë qendrore dhe as kompetenca për t'iu imponuar institucione të tjera për të marrë përsipër dhe zbatuar angazhimet.

Shoqëria civile u angazhua aktivisht gjatë hartimit të planit të veprimit në gjysmën e parë të vitit 2016 por nuk mori pjesë në zbatimin e tij. Pas zgjedhjeve të përgjithshme të qershorit 2017 u formua kabineti i ri (shtator 2017), i cili shkriu MIAP-in, duke e lënë PQH-në pa autoritet koordinimi deri në fund të periudhës së zbatimit. Qeveria shqiptare nuk përgatiti asnjë raport vetë-vlerësimi për planin e veprimit 2016-2018. Forumi me shumë aktorë, OpenAlb, një platformë e hapur ku në periudhën më të mirë kishte 15 organizata dhe bëri të mundur pjesëmarrjen e shoqërisë civile në hartimin e planit të veprimit 2016-2018, ka qenë pasiv që nga muaji dhjetor 2016.

Tabela 1: Në një shikim

	Afat- mesme	Për- fundimtare
Numri i angazhimeve	17	17
Niveli i zbatimit		
I përfunduar	6	9
I konsiderueshëm	4	4
I kufizuar	5	4
Nuk ka filluar	2	0
Angazhime që janë ...		
Qartësisht relevante për një vlerë të PQH	8	
Me ndikim potencial transformues	1	
Të zbatuara ndjeshëm ose plotësisht	10	13
Të treja (👍)	1	1
A mundësoi qeverisje të hapur?		
Konsiderueshëm	1	
Jashtëzakonisht	0	
Për të ardhmen		
Numri i angazhimeve të mbartura për planin tjetër të veprimit	N/A	

Konsultimi me shoqërinë civile gjatë zbatimit

Vendet që marrin pjesë në PQH ndjekin një proces konsultimi gjatë hartimit dhe zbatimit të planit të veprimit. Pas muajit shtator 2017, pikat e kontaktit PQH në ministrinë e linjës dhe në institucionet e tjera që ishin ngarkuar me angazhimet e planit të veprimit nuk funksiononin më ose ishin caktuar në detyra të tjera. Kështu, institucionet përgjegjëse për zbatimin e angazhimeve nuk organizuan takime të mëtejshme me shoqërinë civile ose nuk dhanë informacione se çfarë kishte ndodhur me angazhimet. Gjatë vitit të dytë të zbatimit të planit të veprimit (2017/2018) nuk u bënë takime për PQH. Nuk është realizuar asnjë aktivitet tjetër koordinues nga autoritetet shtetërore apo nga forumi OpenAlb.

Tabela 2: Konsultimi gjatë zbatimit

Forumi i rregullt shumë-aktorësh	Periudha afatmesme	Periudha në fund
1. A ekzistonte forumi	Po	Jo
2. A u mbledh rregullisht?	Jo	Jo

Tabela 3: Niveli i ndikimit të publikut gjatë zbatimit të planit të veprimit

MRP përshtati “Spektrin e Pjesëmarrjes” të hartuar nga Shoqata Ndërkombëtare për Pjesëmarrjen e Publikut (IAP2) për të aplikuar PQH¹. Ky spektër tregon nivelin e mundshëm të ndikimit të publikut tek përmbajtja e planit të veprimit. Në frymën e PQH, shumica e vendeve duhet të synojnë për nivelin “bashkëpunues”.

Niveli i ndikimit të publikut gjatë zbatimit të planit të veprimit		Periudha afatmesme	Periudha përfundimtare
Fuqizues	Qeveria i jep publikut fuqi vendimmarrëse		
Bashkëpunues	Kishte dialog të vazhdueshëm DHE publiku ndihmoi në përcaktimin e agjendës		
Përfshirës	Qeveria dha shpjegime për shqyrtimin e mendimit të publikut		
Konsultues	Publiku pati mundësi të jepte mendimet e tij		
Informues	Qeveria i jep publikut informacion për planin e veprimit	✓	
Pa angazhim	Nuk pati angazhime		✓

¹ Shih http://c.ymcdn.com/sites/www.iap2.org/resource/resmgr/foundations_course/IAP2_P2_Spectrum_FINAL.pdf

Rreth vlerësimit

Treguesit dhe metoda e përdorur në hulumtimin MRP mund të gjenden në Manualin e Procedurave MRP¹. Një masë, “angazhimi me yll” (★), meriton më shumë shpjegime për shkak të interesit të veçantë që paraqet për lexuesit dhe për dobinë e tij me qëllim inkurajimin e një gare drejt kreut mes vendeve pjesëmarrëse në PQH. Angazhimet me yje konsiderohen si angazhime shembullore PQH. Për të marrë një yll, angazhimi duhet të përmbushë disa kriteret:

- Duhet të ketë nivel “mesatar” ose “të lartë” detajimi. Angazhimi duhet të jetë aq specifik (i detajuar) sa të mundësojë gjykimin për ndikimin e tij të mundshëm.
- Gjuha e angazhimit duhet të bëjë të qartë lidhjen e këtij të fundit me qeverisjen e hapur. Në mënyrë të veçantë, duhet të përcaktohet lidhja (relevanca) me të paktën një nga vlerat PQH të aksesit tek informacioni, pjesëmarrja qytetare apo llogaridhënia publike.
- Angazhimi ka ndikim të mundshëm “transformues” nëse zbatohet plotësisht.²
- Qeveria duhet të bëjë progres të dukshëm në këtë angazhim gjatë periudhës së zbatimit të planit të veprimit, duke marrë vlerësimin zbatim “i konsiderueshëm” ose “i përfunduar”.

Angazhimet me yje mund të humbasin statusin e tyre me yll nëse zbatimi i tyre nuk përmbush kriterin e përfundimit të konsiderueshëm apo të plotë në fund të periudhës së zbatimit të planit të veprimit.

Në raportin afatmesëm, plani i veprimit i Shqipërisë përmbante një angazhim me yll. Në fund të afatit, bazuar në ndryshimet e nivelit të zbatimit, plani i veprimit i Shqipërisë kishte ende një angazhim me yll.

- Angazhimi 9: Zbatimi i Ligjit “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”.

Së fundi, tabelat në këtë kapitull paraqesin një pjesë nga gama e madhe e të dhënave që mbledh MRP gjatë procesit të raportimit. Për të parë të gjithë setin e të dhënave për Shqipërinë, referojuni OGP Explorer në www.opengovpartnership.org/explorer.

Në lidhje me “A mundësoi qeverisje të hapur?”

Në përpjekje për të kapur ndryshimet aktuale në praktikën e qeverisë, MRP në raportet përfundimtare prezantoi një variabël të ri – “a mundësoi qeverisje të hapur”. Ky variabël synon të shkojë përtej matjes së produkteve dhe rezultateve duke u përqendruar në ndryshimet që i janë bërë praktikave të qeverisë si rezultat i zbatimit të angazhimit.

Nga mënyra e të shkruarit, disa angazhime PQH janë të paqarta dhe/ose pa lidhje me vlerat PQH, por arrijnë reforma të rëndësishme politike. Në raste të tjera, angazhimet për nga mënyra e të shkruarit duket sikur janë relevante dhe ambicioze, por nuk ia arrijnë të bëjnë të mundur qeverisjen e hapur për nga mënyra e zbatimit. Variabli “A mundësoi qeverisje të hapur?” orvatet të kapë disa nga këto hollësi.

Variabli “A mundësoi qeverisje të hapur?” vlerëson ndryshimet në praktikën e qeverisë duke përdorur spektrin e mëposhtëm:

- I përkeqësoi: qeverisja e hapur përkeqësohet si rezultat i masave të ndërmarra nga angazhimi
- Nuk i ndryshoi: nuk ndryshoi praktikën e qeverisë
- Paksia: janë bërë disa ndryshime, por të vogla për sa i përket ndikimit tek niveli i hapjes së qeverisë.
- Konsiderueshëm: një hap drejt qeverisjes së hapur në fushën përkatëse të politikës, por mbetet i kufizuar në fushëveprim apo shkallë.
- Jashtëzakonisht shumë: një reformë që ka transformuar “punën e zakonshme” në fushën përkatëse të politikës duke nxitur qeverisjen e hapur.

Për të vlerësuar këtë variabël, hulumtuesit që në fillim të planit të veprimit përcaktojnë gjendjen. Më pas, ata vlerësojnë rezultatet e zbatuara për ndryshime në hapjen e qeverisë

Lexuesit duhet të kenë parasysh edhe kufizimet. Raportet përfundimtare të MRP përgatiten vetëm pak muaj pasi ka përfunduar cikli i zbatimit. Variabli fokusohet tek rezultatet që mund të vëzhgohen në praktikën e hapjes së qeverisë në fund të periudhës dyvjeçare të zbatimit. Raporti dhe variabli nuk kanë si qëllim të vlerësojnë ndikimin, për shkak të implikimeve të ndërlikuara metodologjike dhe kuadrit kohor të raportit.

¹ Manuali i procedurave MRP, <http://www.opengovpartnership.org/about/about-irm>.

² Paneli i ekspertëve ndërkombëtarë e ndryshoi këtë kriter në vitin 2015. Për më shumë informacion vizitoni <http://www.opengovpartnership.org/node/5919>.

Zbatimi i angazhimit

Përmbledhje e përgjithshme e angazhimeve

Si pjesë e PQH-së, vendeve u kërkohet të ndërmarrin angazhime në planin dy-vjeçar të veprimit. Tabelat e mëposhtme japin një përmbledhje të nivelit të përfundimit në fund të periudhës dhe ecurinë e matësit “A mundësoi qeverisje të hapur?”. Për angazhimet që u zbatuan në periudhën afatmesme, raporti do të jetë një përmbledhje të gjetjeve të raportit të progresit, por duke u fokusuar në analizën e variablit “A mundësoi qeverisje të hapur?”. Për më shumë hollësi për këto angazhime, lutemi shihni Progres Raportin e Ndërmjetëm të Mekanizmit të Raportimit të Pavarur MRP për Shqipërinë 2017.

Plani i tretë i veprimit PQH i Shqipërisë ka 17 angazhime të organizuara në katër tematika kryesore: 1. Qeveri e hapur për rritjen e aksesit tek informacioni; 2. Qeveri e hapur për krijimin e komuniteteve të sigurta; 3. Qeveri e hapur për modernizimin e shërbimeve publike; dhe, 4. Qeveri e hapur për mbrojtjen e mjedisit. MRP nuk e ndryshoi organizimin e angazhimeve, por i rinumëroi ato për më shumë qartësi. Për shembull, përmirësimi i bazës së të dhënave/portalit me të dhënat e koordinatoreve të së drejtës së informimit dhe programeve të transparencës ka numrin I dhe jo I.I.

Tabela 4: Vlerësim i progresit sipas angazhimit

Përmbledhje e angazhimit	Detajimi				Lidhja me vlerën PQH (siç është shkruar)				Ndikimi i mundshëm				Përfundimi		Afatmesëm Përfundimtar		A mundësoi qeverisje të hapur?				
	Nuk ka	I ulët	Mesatar	I lartë	Akresi tek informacioni	Pjesëmarrja publike	Përgjegjshmëria publike	Tek. e Inov. për transp. e llogaridhënie	Nuk ka	I vogël	Mesatar	Transformues	Nuk ka filluar ende	I kufizuar	I konsiderueshëm	I përfunduar	E përkeqësoi	Nuk e ndryshoi	Paksa	Konsiderueshëm	Jashtëzakonisht shumë
1. Përmirësimi i portalit për akses tek informacioni			✓		✓			✓			✓				✓				✓		
2. Transparenca e buxhetit			✓		✓	✓					✓				✓				✓		
3. Regjistri i integruar i banesave të shtetasve		✓			I paqartë					✓				✓				✓			
4. Regjistri i njoftimeve dhe konsultimeve publike		✓			✓	✓		✓			✓				✓				✓		
5. Arkivi dixhitale		✓			I paqartë					✓				✓				✓			
6. Baza e të dhënave e kërkimeve shkencore				✓	✓			✓			✓		✓					✓			
			✓		✓					✓			✓						✓		

7. Publikimi në internet i legjislacionit të geversisë																				
8. Regjistri elektronik i koncesioneve			✓		✓			✓			✓									✓
9. Zbatimi i Ligjit për Sinjalizimin dhe Mbrojtjen e Sinjalizuesve				✓	✓		✓	✓				✓								✓
10. Ofrimi i shërbimeve elektronike		✓			I paqartë					✓										✓
11. Thjeshtimi i aplikimeve për leje ndërtimi				✓	I paqartë						✓								✓	
12. Ngritja e sporteve dixhitale		✓			I paqartë					✓									✓	
13. Standardizimi i pasaportave të shërbimeve				✓	I paqartë					✓						✓				✓
14. Kartela informative e qytetarit				✓	✓					✓						✓				✓
15. Receta elektronike pilot		✓			I paqartë					✓					✓				✓	
16. Sistemi i monitorimit elektronik të pyjeve				✓	I paqartë					✓			✓						✓	
17. Sistemi elektronik për aplikimet e licencave profesionale				✓	I paqartë					✓						✓			✓	

I. Përmirësimi i portalit për akses tek informacioni

Teksti i angazhimit:

Titulli: Përmirësimi i bazës së të dhënave/portalit me të dhënat e koordinatoreve për të drejtën e informimit dhe programet e transparencës

Aktualisht Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjes së të Dhënave Personale ka krijuar një portal qendror për të aksesuar informacionin në mënyrë që qytetarët të jenë në gjendje të bëjnë kërkesa për informacion online dhe nëse kjo e drejtë nuk përmbushet, ata do të kenë mundësinë të ankohen edhe në internet. Në këtë portal do të ketë një bazë të zgjeruar të dhënash të programeve të transparencës të autoriteteve publike nëpërmjet të cilave informacionet publike ofrohen pa pasur nevojë për kërkesë si dhe të dhëna për koordinatorët për të drejtën e informimit dhe regjistrimin e kërkesave dhe përgjigjeve përkatëse.

Sipas këtij plani veprimi, portali do të përmirësojë modulin e tij për publikimin e ankesave dhe përgjigjeve që qytetarët u drejtohen institucioneve sipas programit të transparencës; portali do të vazhdojë të përditësohet me informacionet më të fundit për këta koordinatorë në secilin institucion.

Ky angazhim nënkupton ofrimin e mundësisë për të gjurmuar informacionin dhe ankesat në mënyrë elektronike nga vetë palët e interesuara.

Institucioni përgjegjës: Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale

Institucion(et) mbështetës(e): Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë (OSFA)

Data e fillimit: 2016

Data e mbarimit: 2018

Shënim redaksional: Për të lexuar të gjithë tekstin e angazhimit, lutemi referojuni https://www.opengovpartnership.org/sites/default/files/Albania_NAP3_ENG.pdf.

	Detajimi				Lidhja me vlerën PQH (siç shkruhet)				Ndikimi i mundshëm				Zbatimi		Afat-mesëm	A mundësoi qeverisje të hapur?					
	Nuk ka	I ulët	Mesatar	I lartë	Akresi në Informacion	Pjesëmarrja qytetare	Llogaridhënia publike	Tek. e Inov. për transp. e llogaridhën.	Nuk ka	I vogël	Mesatar	Transformues	Nuk ka filluar ende	I kufizuar	I konsiderueshëm	I përfunduar	E përkeqësoi	Nuk e ndryshoi	Paksa	Konsiderueshëm	Jashtëzakonisht shumë
Përmbledhje e angazhimit																					
I. Përmirësimi i portalit për aksesin tek informacioni			✓		✓		✓				✓				✓				✓		

Synimi i angazhimit

Në vitin 2014 Shqipëria miratoi një ligj të ri për të drejtën e informimit. Një vit më vonë u krijua dhe u vu në funksionim nga Fondacioni “Shoqëria e Hapur për Shqipërinë” (OSFA) dhe Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale një platformë në internet “Pyet shtetin (www.pyetshtetin.al) për të thjeshtuar procedurat e dorëzimit të kërkesave për informim. Në këtë angazhim bënte pjesë publikimi proaktiv i programeve të transparencës së autoriteteve si dhe

krijimi i një baze të përditësuar të dhënash me emrat e zyrtarëve përgjegjës për trajtimin e kërkesave për informim dhe të dhëna të tjera të hollësishtme kontakti, me mundësinë për të ndjekur përgjigjet e dhëna për kërkesat për informim.

Zbatimi

Periudha afatmesme: I përfunduar

Ky angazhim u zbatua plotësisht brenda vitit të parë të planit të veprimit të OGP-së, në sajë të mbështetjes së dhënë nga OSFA Shqipëri.

Siç parashikohet nga ky angazhim, portali <http://pyetshtetin.al> (Pyet Shtetin) u përmirësua për të përfshirë ndjekjen e ecures së kërkesave për informim dhe ankesat përkatëse nga ana e qytetarëve. Portali kishte një regjistër për kërkesat për informim, të lidhur me regjistrin e secilit institucion shtetëror në nivel qendror e vendor.¹ Portal kishte edhe një regjistër ankesash. Të dy këto instrumente janë të kërkueshëm me motor kërkimi.²

Portali ka informacion të përditësuar për koordinatorët e të drejtës së informimit dhe programeve të transparencës së institucioneve shtetërore.

A mundësoi qeverisje të hapur?

Aksesi tek informacioni: I vogël

Ky angazhim ka sjellë disa ndryshime pozitive për sa i përket përmirësimit të aksesit publik të një sërë kërkesat të paraqitura dhe të përpunuara për informacion si dhe publikimit paraprak të informacionit.

Si rezultat i regjistrave të rinj, portali ka të dhëna statistikore për numrin e kërkesave të paraqitura, numrin e atyre që kanë marrë përgjigje dhe të kërkesave që janë refuzuar. Në krahasim me vitin 2015, numri i kërkesave dhe/ose ankesave të dorëzuara përmes portalit është rritur. Pjesa më e madhe e ankesave (395 nga 560 të tilla) në vitin 2017 u trajtuan me ndërmjetësimin e Komisionerit, për një sasi tjetër prej 66 kërkesash vendimi u mor nga Komisioneri, 77 ankesa nuk kishin bazë ligjore, 8 ishin jashtë afatit dhe 14 ankesa ishin të paplota.³ Në vitin 2017, 130 ankesa nga totali prej 560 ishin bërë nga organizata të shoqërisë civile. Zyrtarë nga zyra e Komisionerit⁴ thanë se në vitin 2018 numri i kërkesave nga qytetarët ishte rritur dukshëm dhe ishte pothuajse i barabartë me numrin e kërkesave të bëra nga OSHC-të, media dhe institucionet jo-shtetërore⁵. Megjithatë, ndonëse jep shifra për numrin e kërkesave për informim, portali nuk ofron informacione për përmbajtjen e këtyre kërkesave ose analizë të përgjithshme të ndonjë lloji tjetër.

Po ashtu, sipas Komisionerit, institucionet e qeverisë qendrore shfaqën probleme për sa i përket transparencës në vitin 2017. Disa nga këto shqetësime lidheshin me mungesën e programeve të përditësuar të transparencës. Prandaj, progresi i arritur në këtë angazhim në lidhje me aksesin tek informacioni dhe zbatimin e Ligjit për të Drejtën e Informimit mund të konsiderohet si i vogël.

Hapat e mëtejshëm

Në kohën e përpilimit të këtij raporti, Shqipëria nuk e kishte publikuar ende planin e mëtejshëm të veprimit. Hulumtuesi MRP rekomandon që në të ardhmen qeveria shqiptare të përmirësojë më tej zbatimin e ligjit për të drejtën e informimit dhe funksionimin e portalit të transparencës duke plotësuar informacionin sasior me informacion cilësor për kërkesat dhe ankesat e paraqitura.

¹ Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë (OSFA), <http://pyetshtetin.al/rregjistri-i-kerkesave/>

² Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë (OSFA), portal, <http://pyetshtetin.al/rregjistri-i-ankesave/>

³ Raporti vjetor 2017 i Komisionerit për të Drejtën e Informimit, http://www.idp.al/wp-content/uploads/2018/02/RAPORTI_VJETOR_2017.pdf

⁴ Amarilda Xhyheri, intervistë nga Hulumtuesi MRP, 11 dhjetor 2018

⁵ Regjistri online në adresën <https://pyetshtetin.al/rregjistri-i-ankesave/>

2. Transparenca e buxhetit

Teksti i angazhimit:

Transparenca në financat publike është një element kyç i qeverisë, kështu që informacioni për buxhetin që publikohet në kohë të jetë lehtësisht i kapshëm dhe i qartë për qytetarët. Ky angazhim rrit më tej stabilitetin makroekonomik dhe fiskal si dhe mundëson normat më të larta të rritjes ekonomike. Përveç kësaj, ai ndihmon në përmirësimin e efikasitetit të shpenzimeve publike. Ministria e Financave i ka kushtuar vëmendje të madhe transparencës buxhetore, duke e vendosur atë në krye të prioritetëve të saj, të materializuar në Strategjinë e Financave Publike 2014-2020.

Përmirësimi i transparencës së buxhetit nëpërmjet këtij angazhimi do të arrihet me anë të:

- Përgatitjes së të gjitha dokumenteve të nevojshme për buxhetimin, në një format të tillë që struktura e tyre të jetë e qartë dhe e kuptueshme për qytetarët;
- Publikimit në kohë të këtyre dokumenteve;
- Publikimit në faqen zyrtare të Ministrisë së Financave dhe në media i të gjitha aktiviteteve të kryera nga Ministria, përfshirë këtu dëgjuesat për programin e buxhetit afatmesëm për arritjen e pjesëmarrjes aktive të përfaqësuesve nga organizata të ndryshme, si qytetarë, OJQ, shoqëria civile, qeveria qendrore dhe vendore e të gjitha niveleve.

Institucioni përgjegjës: Ministria e Financave

Institucion(et) mbështetës(e): Partnerët Shqipëri, Instituti Shqiptar i Shkencave, etj.

Data e fillimit: 2016

Data e mbarimit: 2018

Shënim redaksional: Për të lexuar të gjithë tekstin e angazhimit, lutemi referojuni https://www.opengovpartnership.org/sites/default/files/Albania_NAP3_ENG.pdf.

Përmbledhje e angazhimit	Detajimi				Lidhja me vlerën PQH (siç shkruhet)				Ndikimi i mundshëm				Zbatimi		Afat-mesëm Përfundimtar		A mundësoi qeverisje të hapur?				
	Nuk ka	I ulët	Mesatar	I lartë	Akresi në Informacion	Pjesëmarrja qytetare	Llogaridhënia publike	Tek. e Inov. për transp. e llogaridhën.	Nuk ka	I vogël	Mesatar	Transformues	Nuk ka filluar ende	I kufizuar	I konsiderueshëm	I përfunduar	E përkeqësoi	Nuk e ndryshoi	Paksa	Konsiderueshëm	Jashtëzakonisht shumë
2. Transparenca e buxhetit			✓		✓	✓					✓				✓				✓		

Synimi i angazhimit

Ky angazhim synon të përmirësojë transparencën dhe pjesëmarrjen e publikut në procesin e hartimit të buxhetit të shtetit. Qëllimi ishte të rritej aksesi dhe sasia e dokumenteve buxhetore si dhe që këto dokumente të bëheshin sa më të thjeshta për t'u kuptuar nga qytetarët. Këto masa vijnë në kuadër të reformave të ndërmarra për anëtarësimin në BE si dhe në përgjigje të gjetjeve nga Partneriteti

Ndërkombëtar për Buxhetin, i cili rekomandoi në Sondazhin e Buxhetit të Hapur 2015 se Shqipëria publikon një sërë dokumentesh buxhetore, përfshirë këtu raportin vjetor dhe raportin 6-mujor si dhe “Buxhetin e Qytetarëve”.¹

Zbatimi

Periudha afatmesme: e konsiderueshme

Në periudhën afatmesme, ky angazhim ishte zbatuar konsiderueshëm. Buxheti për Qytetarët për vitin 2016 dhe lista e investimeve publike të parashikuara nga programi buxhetor afatmesëm (parashikim 3-vjeçar i buxhetit të shtetit) ishte publikuar në kohë. Buxheti gjinor (buxhetet e përgatitura dhe analizuar nga perspektiva gjinore) për programin buxhetor afatmesëm² dhe raportet e rregullta të monitorimit për secilën ministri ishin publikuar çdo tremujor nga Ministria e Financave (MF) në faqen e saj zyrtare³. Megjithatë, MF nuk përfshiu shoqërinë civile apo grupet e tjera të interesit në procesin e hartimit të buxhetit. Konsultimi publik u bë gjatë procedurës së miratimit të buxhetit në Parlament por jo gjatë procesit të hartimit të buxhetit.

Periudha përfundimtare: e konsiderueshme

Në vitin 2018, qeveria vazhdoi me zbatimin e masave që lidhen me transparencën e buxhetit edhe pse në një shkallë më të ulët. Në faqen zyrtare të MF-së⁴ u publikua Buxheti për Qytetarët 2018, ndërsa shtatë (nga 11) ministri të linjës dhe nëntë institucione të pavarura publikuan raportet e monitorimit⁵. Deri në fund të vitit 2018 Ministria e Financave publikoi analizat e monitorimit të performancës ku tregojë se si e kishin shpenzuar buxhetin institucionet për tremujorin e parë të 2018, që është një hap mbrapa krahasuar me situatën në periudhën afatmesme.⁶

Në 26 tetor 2018 Ministri i Financave shpalli miratimin nga Këshilli i Ministrave i projektbuxhetit të vitit 2019.⁷ MF e publikoi në internet këtë projektbuxhet në tetor 2018.⁸ Asnjë lloj informacioni për konsultimin publik nuk është dhënë dhe hulumtuesi MRP nuk mundi të evidentonte ndonjë aktivitet të realizuar me grupet e interesit në lidhje me projektbuxhetin.

A mundësoi qeverisje të hapur?

Aksesi tek informacioni: I vogël

Pjesëmarrja qytetare: Nuk ndryshoi

Veprimi i qeverisë për rritjen e transparencës së buxhetit dhe pjesëmarrjen e publikut në hartimin e buxhetit nuk ka qenë konstant gjatë periudhës së raportimit. Ndërkohë që për buxhetin e shtetit për vitin 2017 progresi ishte i konsiderueshëm me pak mangësi në elementin e konsultimit publik, në 2018 progresi ka qenë më i ngadaltë. Në fakt, nga ana e MF nuk u publikua asnjë projektbuxhet apo “dokumente të tjera të nevojshme që kërkohen për hartimin e buxhetit” (siç parashikohet nga angazhimi) në vitin 2018.

Projektbuxheti për vitin 2019 u miratua në një mbledhje qeverie të mbajtur në 26 tetor 2018 dhe u publikua më tej në faqen e MFNg monitorimi nga shoqëria civile^{9,10} sugjerohet se ka ende vend për përmirësim të performancës së qeverisë veçanërisht në lidhje me konsultimin e projektbuxhetit. Po ashtu, edhe pse veprimet e ndërmarra përbëjnë një zhvillim pozitiv për transparencën e buxhetit në Shqipëri, nuk është bërë ende mjaftueshëm për të siguruar pjesëmarrjen aktive të qytetarëve.

Si rezultat, ndryshimet e nxitura nga ky angazhim mund të përshkruhen si të vogla në krahasim vetëm me vlerën e aksesit tek informacioni. Kjo për shkak se zbatimi i angazhimit nuk bëri të mundur rritjen e pjesëmarrjes së publikut në fazën e hartimit të buxhetit as për 2018 dhe as për 2019, edhe pse ofroi disa informacione që mund të bënin që publiku ta kuptonte më mirë buxhetin dhe të ndihmonte aktorët e tjerë (p.sh., media dhe shoqatat e bizneseve) të ndiqnin zbatimin e buxhetit. Edhe pse në planin e veprimit janë përmendur disa OSHC si institucione mbështetëse, MF nuk i ka angazhuar ato në zbatimin e këtij angazhimi.

Hapat e mëtejshëm

Në kohën kur po shkruhej ky raport, plani tjetër i veprimit nuk ishte publikuar ende. Hulumtuesi MRP rekomandon që në planin tjetër të veprimit të përfshihen masa që sigurojnë se pjesëmarrja dhe publikimi i dokumenteve të buxhetit të bëhen detyrim ligjor. Për më tepër, hulumtuesi MRP sugjeron se MF duhet të marrë masa proaktive për të nxitur pjesëmarrjen dhe angazhimin kuptimplotë të qytetarëve dhe grupeve të interesit në hartimin e buxhetit. MF duhet të bëjë më shumë përpjekje me qëllim që informacioni për buxhetin të përdoret sa më mirë.

¹ Sondazhi për buxhetin e hapur 2017 për Shqipërinë, Partneriteti Ndërkombëtar për Buxhetin, <https://www.internationalbudget.org/open-budget-survey/results-by-country/country-info/?country=al>

² “Buxheti i përgjegjshëm gjinor në programin buxhetor afatmesëm 2016-2018”, Ministria e Financave, <http://www.financa.gov.al/wp-content/uploads/2017/12/infographic-budgeting-AL-1.pdf>

³ Raporte monitorimi nga ministritë e linjës për 2017, Ministria e Financave, <http://www.financa.gov.al/raporte-monitorimi-nga-ministrite-e-linjes-2017/>

⁴ “Buxheti 2018 Një vështrim për qytetarët”, Ministria e Financave, http://www.financa.gov.al/wp-content/uploads/2018/06/Buxheti_2018.pdf

⁵ Raportet mund të gjenden në faqen zyrtare të MF, <http://financa.gov.al/raporte-monitorimi-nga-ministrite-e-linjes-2018/>

⁶ Analizë e performancës së institucioneve, <http://financa.gov.al/monitorimi-4-mujori-i-pare-2018/>

⁷ Konferencë shtypi nga Ministri Ahmetaj, <http://oranews.tv/article/buxheti-2019-ahmetaj-rritje-pagash-edhe-perpunonjesit-e-burgjeve-e-diplomatet>

⁸ Në fakt, i vetmi vendim që lidhet me buxhetin e shtetit të miratuar nga qeveria qendrore në këtë seancë ka të bëjë me një rishpërndarje të fondeve buxhetore të vitit 2018. Shih VKM e miratuar në 26.10.2018

<https://www.kryeministria.al/newsroom/vendime-te-miratuara-ne-mbledhjen-e-keshillit-te-ministrave-date-26-tetor-2018/>

⁹ Raporti i OSFA 2016, <http://www.osfa.al/publikime/fondacioni-prezanton-analizen-e-projektbuxhetit-2016-dhe-monitorimin-e-buxhetimit-te-prioriteteve-te-integrimit-ne-projektbuxhetin-2016>

¹⁰ Raporti i OSFA 2017, <http://www.osfa.al/publikime/fondacioni-prezanton-analizen-e-projektbuxhetit-2017-dhe-monitorimin-e-buxhetimit-te-prioriteteve-te-integrimit-ne-projektbuxhetin-2017>

3. Regjistri i integruar i banesave te shtetasve

Teksti i angazhimit:

Mungon një regjistër i integruar i banesave të shtetasve.

Regjistrimi i shtetasve në banesat e tyre do të bëjë të mundur që shumë shërbime të ofrohen për qytetarët nga shtëpitë e tyre; këto shërbime do të ridimensionohen pas krijimit të kësaj baze të dhënash.

Një aspekt i rëndësishëm i këtij shërbimi është regjistrimi i banesave të emigrantëve shqiptarë. Kjo do të mundësojë informacione të rëndësishme me përdorim të gjerë nga institucionet shtetërore dhe private (vota e emigrantëve, gjobat në shtëpi dhe shumë përdorime të tjera).

Në të gjithë procesin do të përfshihen qytetarët për të verifikuar saktësinë dhe integritetin e të dhënave; një shembull për këtë është që të dhënat për regjistrimin e emigrantëve të merren përmes vetë-deklarimit. Po ashtu, opinionet e qytetarëve do të merren përmes zyrave të bashkisë dhe zyrave të gjendjes civile në të gjithë vendin.

Regjistrimi i shtetasve në banesat e tyre do të bëjë të mundur që shumë shërbime të ofrohen për qytetarët nga shtëpitë e tyre; këto shërbime do të ridimensionohen pas krijimit të kësaj baze të dhënash. Një aspekt i rëndësishëm i këtij shërbimi është regjistrimi i banesave të emigrantëve shqiptarë. Kjo do të mundësojë informacione të rëndësishme me përdorim të gjerë nga institucionet shtetërore dhe private (vota e emigrantëve, gjobat në shtëpi dhe shumë përdorime të tjera).

- Rritja e cilësisë së shërbimeve për qytetarët nëpërmjet regjistrimit të banesave
- Shkrimi dhe Regjistri Kombëtar të Adresave me Regjistrin e Gjendjes Civile
- Popullimi i adresave të qytetarëve

Institucioni përgjegjës: Ministria e Brendshme

Institucion(et) mbështetës(e): N/A

Data e fillimit: 2016

Data e mbarimit: 2018

Përmbledhje e angazhimit	Detajimi				Lidhja me vlerën PQH (siç shkruhet)				Ndikimi i mundshëm				Zbatimi				Afat-mesëm Përfundimtar				A mundësoi qeverisje të hapur?			
	Nuk ka	I ulët	Mesatar	I lartë	Aksesi në Informacion	Pjesëmarrja qytetare	Llogaridhënia publike	Tek. e Inov. për transp. e llogaridhën.	Nuk ka	I vogël	Mesatar	Transformues	Nuk ka filluar ende	I kufizuar	I konsiderueshëm	I përfunduar	E përkeqësoi	Nuk e ndryshoi	Paksa	Konsiderueshëm	Jashtëzakonisht shumë			
3. Regjistri i integruar i banesave të qytetarëve		✓			I paqartë					✓				✓				✓						

Synimi i angazhimit

Gjatë 25 viteve të fundit, vlerësohet se rreth 1.4 milionë shqiptarë kanë emigruar, ndërsa migrimi i brendshëm e ka shoqëruar këtë trend veçanërisht në dy dekadat e para që nga rënia e sistemit komunist në 1990. Këto lëvizje migratore nuk janë regjistruar në regjistrin civil të shtetasve shqiptarë. Ky angazhim synon të krijojë regjistër të integruar të vendbanimit të shtetasve për të bërë mundur një bazë të vetme të saktë të dhënash me informacione për qytetarët shqiptarë, ku do të përfshihen të gjitha të dhënat për qytetarët (emri, ditëlindja, numri i identifikimit, etj.) dhe Regjistrin Kombëtar të Adresave.

Zbatimi

Periudha afatmesme: I kufizuar

Edhe pse nuk shprehej qartë në tekstin e angazhimit, hulumtuesi i MRP-së konstatoi se qeveria kishte parashikuar tre hapa për krijimin e regjistrit të integruar: 1) ndryshimin e Ligjit nr. 9270, “Për sistemin e adresave”, 2) nisjen e procesit të popullimit të bazës së të dhënave, dhe 3) pilotimin e regjistrit të banesave. Në procesin e popullimit të bazës së të dhënave përfshihen vendosja e kodeve të reja për familjet dhe më pas hedhjen në bazën e të dhënave të informacionit (p.sh. numri i banorëve të familjeve, profesionet). Regjistri i integruar i vendbanimit të qytetarëve ishte njoftuar nga Ministri i Brendshëm në nëntor 2015.¹ Në shtator 2016, Kuvendi i Shqipërisë miratoi Ligjin nr. 89/2016 “Për disa ndryshime në Ligjin nr. 9270, datë 29.07.2004, “Për sistemin e adresave”, të ndryshuar”.² Në tetor 2016, filloi procesi i popullimit të bazës së të dhënave.³ Në korrik 2017, autoritetet shqiptare shtynë afatin për qytetarët në bashkitë pilot Tiranë, Durrës dhe Elbasan për të regjistruar adresën e vendbanimit deri në muajin janar të vitit 2018.⁴ Në tetor 2017, përfaqësuesi i qeverisë për këtë angazhim raportoi se pilotimi i regjistrit të integruar ishte në proces.⁵ Progresi i Shqipërisë në zbatimin e këtij angazhimi në fazën afatmesme ishte i kufizuar.

Periudha përfundimtare: I kufizuar

Afati për regjistrimin e adresave në bashkitë pilot u shty për 30 janar 2018⁶. Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE), ndërmarrje në pronësi publike që ishte përfshirë në projektin “Një qytetar, një adresë”, u kërkoi qytetarëve të përditësonin adresat në portalin <http://oshee.al/perditesim/>. Procesi i regjistrimit të adresave të qytetarëve u shtri në të gjithë vendin. Në tetor 2018, Ministria e Brendshme, Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, propozuan një amnisti 6-mujore për ata qytetarë që nuk kishin përditësuar të dhënat e adresës në regjistrin civil.⁷

Në bazë të ligjit për identifikimin dhe regjistrimin e adresave të shtetasve shqiptarë që banojnë jashtë territorit të Shqipërisë⁸, në VKM Nr. 405, datë 04.07.2018, përcaktoheshin rregullat dhe kërkesat për raportimin e vendbanimit jashtë.⁹ Në kohën e hartimit të këtij raporti (tetor 2018), portali në internet për regjistrimin e adresave në faqen zyrtare të Ministrisë së Brendshme nuk ishte vënë në punë ende.

Pas fazës së pilotimit në tre bashki, progresi i zbatimit të këtij angazhimi në nivel kombëtar është i paqartë, sepse nuk ka informacioni zyrtar nga institucionet përgjegjëse për statusin e zbatimit të tij. Po ashtu, është e paqartë nëse ka përfunduar unifikimi i dy regjistrave - Regjistri Kombëtar i Adresave dhe Regjistri i Gjendjes Civile.¹⁰

A mundësoi qeverisje të hapur?

Aksesi tek informacioni: Nuk ndryshoi

Pjesëmarrja qytetare: Nuk ndryshoi

Llogaridhënia publike: Nuk ndryshoi

Angazhimi nuk kishte lidhje me asnjë nga vlerat PQH, sepse ka të bëjë me regjistrimin e qytetarëve, por nuk parashikonte asnjë publikim informacioni apo pjesëmarrje të qytetarëve në vendimmarrje.

Për nga mënyra e zbatimit, angazhim nuk solli ndonjë ndryshim që do të ishte me rëndësi për hapjen e qeverisë.

Hapat e mëtejshëm

Në kohën e hartimit të këtij raporti, planit i katërt i veprimit PQH i Shqipërisë nuk ishte publikuar ende, ndaj nuk është e qartë nëse ky angazhim do të vazhdojë.

¹ Ministria e Brendshme, <http://www.punetebrendshme.gov.al/all/newsroom/fjalime/prezantohet-projekti-i-regjistrimit-te-adresave-dhe-shtetasve-popullimi&faqe=2>, aksesuar në shtator 2018.

² Ligji Nr. 89/2016, http://www.qbz.gov.al/botime/fletore_zyrtare/2016/PDF-2016/185-2016.pdf

³ Deklaratë e Ministrit të Brendshëm për nisjen e procesit, <http://www.punetebrendshme.gov.al/all/te-rejat/lajme/vlore-tahiri-nis-procesi-i-popullimit-punesohen-1200-te-rinj-per-regjistrimin-e-shqiptareve>

⁴ Shtyhet afati për regjistrimin e adresës së banesave, <http://www.panorama.com.al/adresat-e-reja-kaos-ne-zyrat-e-gjendjes-civile-nga-sot-nis-vendosja-e-gjobave/>

⁵ Loran Sevi, Ministria e Brendshme, intervistë nga Hulumtuesi MRP, tetor 2017.

⁶ “Shtyhet afati për regjistrimin e adresës së banesave deri më 30 janar 2018”, <http://www.spektrum.al/afati-per-regjistrimin-e-adresave-deri-me-30-janarit-2018/>

⁷ Scan TV “Amnisti 6 muaj për qytetarët që s’kanë korrigjuar vendbanimin”, tetor 2018, https://www.youtube.com/watch?v=QfP8A_yq2_U

⁸ Ligji Nr. 14/2016 datë 18 shkurt 2016, http://www.qbz.gov.al/botime/fletore_zyrtare/2016/PDF-2016/37-2016.pdf

⁹ VKM. 405 datë 4 korrik 2018, <http://www.qbz.gov.al/Botime/Akteindividuale/Janar%202018/Fletore%20101/VKM%20nr.%20405.%20date%204.7.2018.pdf>

¹⁰ Raporti i AKSHI 2017 thotë se regjistri kombëtar i gjendjes civile është në punë, faqe 36, <http://akshi.gov.al/wp-content/uploads/2018/04/raporti-vjetor-2017-AKSHI.pdf>

4. Regjistri i njoftimeve dhe konsultimeve publike

Teksti i angazhimit:

Titulli: Krijimi i një regjistri elektronik për njoftimet dhe konsultimet publike

Krijimi i regjstrit për njoftimet dhe konsultimet publik i përket zbatimit të Ligjit nr. 146/2014 "Për njoftimin dhe konsultimin publik".

Në këtë kontekst, ky sistem është hartuar si seksion në formën e një forumi unik virtual interaktiv në portalin e shërbimeve qeveritare e-Albania.al. Çdo institucion vendimmarrës dhe ligjvënës, nëpërmjet një përdoruesi që do të veprojë si koordinator i institucionit, do të publikojë për konsultim me qytetarët dhe grupet e interesit çdo projekt ose draft para miratimit të tij.

Përfshirja e këtij regjistri unik qeveritar tek portali e-Albania.al dhe përfshirja e sistemit të konsultimit publik brenda tij do të rrisë familjarizimin dhe aksesin e qytetarëve në sistem.

Ky investim synon të rrisë transparencën dhe angazhimin e publikut në qeverisje për të përmbushur nevojat për krijimin e sistemit funksional për njoftim dhe konsultim publik.

Përmes këtij regjistri do të sigurohen aksesin dhe mundësia e komunikimit të të gjitha palëve të interesuara. Kjo formë siguron dhe forcon barazinë për sa i përket aksesit në informacion dhe shërbime, duke marrë parasysh nevojat specifike të individëve ose grupeve të caktuara. Ky angazhim synonte edhe rritjen e transparencës dhe të angazhimit të publikut në qeverisje.

Institucioni përgjegjës: Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI)

Institucion(et) mbështetës(e): Ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike; Ministrinë e linjës

Data e fillimit: 2016

Data e mbarimit: 2018

	Detajimi				Lidhja me vlerën PQH (siç shkruhet)				Ndikimi i mundshëm				Zbatimi		Afat-mesëm Përfundimtar		A mundësoi qeverisje të hapur?				
	Nuk ka	I ulët	Mesatar	I lartë	Akresi në Informacion	Pjesëmarrja qytetare	Llogaridhënia publike	Tek. e Inov. për transp. e llogaridhën.	Nuk ka	I vogël	Mesatar	Transformues	Nuk ka filluar ende	I kufizuar	I konsiderueshëm	I përfunduar	E përkeqësoi	Nuk e ndryshoi	Paksa	Konsiderueshëm	Jashtëzakonisht shumë
Përmbledhje e angazhimit																					
4. Regjistri i njoftimeve dhe konsultimeve publike			✓		✓	✓	✓				✓					✓			✓		

Synimi i angazhimit

Në zbatim të Ligjit “Për njoftimin dhe konsultimin publik” të vitit 2014, në 2015 u krijua në portal për konsultimet publike mbi projektligjet (www.konsultimipublik.gov.al), por nuk ishte vënë plotësisht në punë para miratimit të këtij angazhimi. Në këtë kontekst, ndërlidhja e këtij instrumenti të konsultimit publik me portalin e-albania.al u konsiderua si një mundësi për të rritur njohjen dhe përhapjen e tij. Kjo, nga ana tjetër, do të përmirësonte aksesin e publikut tek informacioni për projekt ligjet në faza të ndryshme të tyre para se të shkonte në parlament për miratim dhe ndjekjen nga qytetarë të vendimmarrjes.

Zbatimi

Periudha afatmesme: I përfunduar

Regjistri për njoftimet dhe konsultimet publike (www.konsultimipublik.gov.al) u përditësua dhe integrua me portalin e-albania (ndonëse të dy portalet ekzistonin para këtij angazhimi). Portali i ri i integruar ka edhe një seksion për konsultimet me qytetarët dhe një seksion të veçantë për konsultimet me ekspertët. Hulumtuesit MRP nuk iu ofrua asnjë informacion në lidhje me numrin e përdoruesve të regjistruar.

Ndërlidhja me portalin e-albania shërben si regjistrim përdoruesi dhe identifikim për portalin e konsultimeve. Nuk kërkohet regjistrim për të aksesuar aktet në procedurën e konsultimit publik në adresën www.konsultimipublik.gov.al. Megjithatë, regjistrimi është i detyrueshëm përmes portalin e-albania.al me qëllim komentimin për aktet në seksionin e konsultimit. Lutemi referojuni Raportit të Ndërmjetëm MRP 2017 për më shumë hollësi.¹

Në periudhën afatmesme ky angazhim ishte përfunduar me krijimin e një regjistri elektronik për njoftimet dhe konsultimet publike me anë të integritit të www.konsultimipublik.gov.al dhe e-Albania.

A mundësoi qeverisje të hapur?

Aksesi tek informacioni: I vogël Pjesëmarrja qytetare: Nuk ndryshoi

Edhe pse zbatimi i këtij angazhimi u bë në kohë, rezultatet e tij nuk sollën ndryshime të konsiderueshme në praktikën e qeverisë për konsultimet publike, me progres të kufizuar në aksesin tek informacioni. Në vitin 2018, qeveria vijoi me përditësimin e portalit me projektligje të reja për konsultim nga publiku. Kështu, në portal u publikuan edhe 42 projektligje në periudhën fundi i 2017 deri në tetor 2018. Kjo e çon numrin e projektligjeve për konsultim me qytetarët në 59, që është rritje mjaft e konsiderueshme, krahasim me vetëm 15 projekt ligje të raportuara nga MRP në vitin 2017.

Ndonëse publikimi i projektligjeve në këtë portal të integruar përmirëson aksesin tek informacioni në një shkallë të caktuar, faqja zyrtare e Kuvendit (<http://www.parlament.al/Projektligje/IndexList>) ofron një bazë të dhënash shumë më të plotë të projektligjeve, që përdoren nga grupet e interesit për t'u njohur dhe për të përgatitur qëndrimin e tyre gjatë konsultimeve në procedurat parlamentare. Megjithatë, ajo bazë të dhënash nuk ka elementë që ndihmojnë në përdorimin praktik të saj, si futja dhe publikimi i komenteve, opinioneve dhe rekomandimeve për projektligjet, si në rastin e portalit www.konsultimipublik.gov.al. Nga ana tjetër, portali krijon praktikën e mirë të publikimit të projektligjeve dhe strategjive në fazën përgatitore para se të kalojnë në procedurat e miratimit nga Parlamenti. Megjithatë, angazhimi i ulët i publikut, qytetarëve dhe grupeve të interesit me portalin sugjeron se një gjë e tillë nuk ka sjellë përmirësim të konsiderueshëm të cilësisë apo sasisë së informacionit që publikohet. Kështu, ky angazhim ka bërë të mundur përmirësime të vogla në aspektin e aksesit tek informacioni.

Për sa i përket pjesëmarrjes së qytetarëve, në portalin e ri nuk u bënë sugjerime/komente nga qytetarët apo ekspertët për asnjë nga projektligjet ose strategjitë që ishin publikuar për konsultimin nga publiku gjatë 2017 dhe 2018. Pak pjesëmarrës të fokus grupeve (përfaqësues të OSHC-ve vendore) të organizuar nga hulumtuesi MRP sugjeruan se arsyet kryesore për kontribut të kufizuar

me sugjerime e komente ishte kushti për t'u regjistruar në portalin e-Albania dhe mungesa e ndërgjegjësimit publik për portalin. Sipas AKSHIT-t, login nëpërmjet e-Albania është i domosdoshëm për të siguruar që të gjitha komentet vijnë persona realë dhe jo llogari false.²

Edhe pse portali krijoi mundësi për ndikim në bërjen e ligjeve, pengesat (si regjistrimi në portalin e-albania) kufizoi mundësinë e përdorimit të hapësirave të tilla. Prandaj, zbatimi i këtij angazhimi nuk sollti ndryshime në nivelin e pjesëmarrjes së qytetarëve.

Hapat e mëtejshëm

Në kohën kur po përgatitej ky raport, Shqipëria nuk e kishte publikuar ende planin e ri të veprimit. Ky raport përsërit rekomandimet e progres raportit të vitit 2017. Portali www.konsultimipublik.gov.al mbetet një mundësi e rëndësishme e konsultimit publik online, që do të ishte i dobishëm nëse do të promovohet më gjerë nëpërmjet një fushate të ndërgjegjësimit publik me anë të mediave tradicionale. Sipas AKSHI-t, Agjencia i ka sugjeruar zyrës së Kryeministrit tu kërkojë të gjitha ministrive të publikojnë të gjitha nismat ligjore konsultuese në portal dhe të ndërmarrin fushata njoftimi për të përdorur portalin e konsultimit publik. Gjithashtu i sugjeroi zyrës të publikojë projekt aktet legjislative të veta në media sociale / faqe internet dhe të ftojë qytetarët të komentojnë mbi projekt ligjet dhe projekt vendimet e publikuara.³

Për të përmirësuar kuadrin e konsultimit publik, qeveria duhet të bëjë më shumë përpjekje duke hartuar procedura ligjore që rregullojnë angazhimin publik në hartimin e politikave. Kur publikon projektligje, qeveria duhet të ofrojë afate të përshtatshme kohore për konsultime, të krijojë rregulla të qarta për të orientuar konsultimet dhe të reagojë ndaj komenteve të qytetarëve.

¹ Raporti i Progresit të Shqipërisë nga MRP 2016-2017, https://www.opengovpartnership.org/sites/default/files/Albania_Mid-Term_2016-2018_EN_for-pub-comm.pdf

² MRP e mori këtë informacion nga AKSHI gjatë periudhës së para-publikimit të këtij raporti.

³ Ibid

5. Arkiva Dixhitale

Teksti i angazhimit:

Angazhimi i propozuar nga Ministria e Zhvillimit Urban dhe Arkivi Qendror Teknik i Ndërtimit ka si objektiv të përgjithshëm monitorimin e respektimit të zhvillimit të Axhendës Dixhitale në Shqipëri dhe standardeve të pranuar teknologjike të referuara nga organe të ngjashme në vendet e tjera të BE-së si dhe nga institucionet homologe në vend. Arkivi duhet të kthehet në një aset me bazë teknologjike për akses tek informacioni, i konvertueshëm dhe i krahasueshëm me arkivat e ngjashme evropiane, duke përmirësuar efektivitetin e shërbimit që u ofrohet qytetarëve përmes:

- Ofrit të shërbimeve në internet/intranet nëpërmjet aksesit për qytetarët/subjektet dhe palët e tjera të interesuara që i kërkojnë këto shërbime, akses tek mundësitë materiale në internet.
- Krijimit të mundësive për publikimin e shërbimeve teknologjike dhe infrastrukturore, përfitimeve në kohë reale në uljen e kostove të shërbimeve, proceseve njerëzore të automatizuara për kursimin e energjisë.
- Reduktimit të përdorimit të dokumenteve dhe materialeve të tjera arkivore të origjinalit duke rritur shkallën e përdorimit të tyre në formë elektronike.

Institucioni përgjegjës: Arkivi Qendror Teknik i Ndërtimit/Ministria e Zhvillimit Urban

Institucion(et) mbështetës(e): N/A

Data e fillimit: 2016

Data e mbarimit: 2018

Shënim redaksional: Për të lexuar të gjithë tekstin e angazhimit, lutemi referojuni https://www.opengovpartnership.org/sites/default/files/Albania_NAP3_ENG.pdf.

Përmbledhje e angazhimit	Detajimi				Lidhja me vlerën PQH (siç shkruhet)				Ndikimi i mundshëm				Zbatimi		Afat-mesëm		A mundësoi qeverisje të hapur?				
	Nuk ka	I ulët	Mesatar	I lartë	Akresi në Informacion	Pjesëmarrja qytetare	Llogaridhënia publike	Tek. e Inov. për transp. e llogaridhën.	Nuk ka	I vogël	Mesatar	Transformues	Nuk ka filluar ende	I kufizuar	I konsiderueshëm	I përfunduar	E përkeqësoi	Nuk e ndryshoi	Paksa	Konsiderueshëm	Jashtëzakonisht shumë
5. Arkivi dixhital	✓				I paqartë				✓				✓				✓				

Synimi i angazhimit

Ky angazhim bazohet në punën për “Axhendën dixhitale” të miratuar nga qeveria në vitin 2015. Duke qenë se Arkivi Qendror Teknik i Ndërtimit (institucioni përgjegjës për mbledhjen dhe administrimin e dokumenteve teknike të ndërtimit) nuk kishte një bazë të digjitalizuar të dhënash, me këtë angazhim synohej të ngrihej një arkiv dixhital si aset të bazuar në teknologji për akses informacioni, të konvertueshëm dhe të krahasueshëm me arkivat e ngjashme evropiane. Rezultatet e pritshme ishin përmirësimet në efektivitetin e shërbimeve publike. Në mënyrë të veçantë, kjo bazë e digjitalizuar të dhënash do të ulë kostot dhe vonesat për qytetarët që duan të marrin dokumentacion në Arkivin

Qendror Teknik të Ndërtimit (duke rritur gamën e formularëve elektronikë) dhe për firmat e ndërtimit që do të jenë në gjendje të aplikojnë më lehtë për leje ndërtimi.

Zbatimi

Periudha afatmesme: I kufizuar

Në periudhën e përgatitjes së progres-raportit MRP (gusht-shtator 2017), qeveria shqiptare po ndërmerrte procesin e ristrukturimit dhe shkriu Ministrinë e Zhvillimit Urban. Intervistat e hulumtuesit MRP me ish punonjës të Ministrisë dhe zyrtarë në detyrë të Arkivit Qendror Teknik të Ndërtimit konfirmuan planet për ngritjen e një arkive dixhitale, por nuk ishin në dijeni që ky projekt ishte angazhim PQH.¹ Kështu, raporti i progresit për 2017 konstatoi se zbatimi i këtij angazhimi ishte i kufizuar dhe jashtë afatit. Hulumtuesi MRP mundi të gjente vetëm një VKM Nr. 365, datë 26.04.2017 “Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore “Arkivi digjital i Arkivit Qendror Teknik të Ndërtimit.”

Periudha përfundimtare: I kufizuar

Gjatë vitit të dytë të zbatimit u evidentua progres i kufizuar.

Në raportin e AKSHI-it për 2017 theksohej se arkivi digjital i Arkivit Qendror Teknik të Ndërtimit si një nga bazat e të dhënave të cilave iu kishte shërbyer në 2017, edhe pse faqja zyrtare e Arkivit Qendror Teknik të Ndërtimit nuk kishte asnjë informacion për Arkivin Digjital.²

Hulumtuesi MRP gjeti në vitin 2018 “Sistemin e centralizuar multifunksionale të lejeve të ndërtimit” në portalin e-Albania³, që i përket një prej objektivave të përcaktuar në këtë angazhim: firmat e ndërtimit do ta kenë më të lehtë të aplikojnë për leje ndërtimi dhe individët do të jenë në gjendje të aksesojnë online hartat e pronave të tyre. Ky shërbim online përfshin opsionin e interoperabilitetit duke lidhur kështu të 61 bashkitë në vend dhe institucionet shtetërore përkatëse përgjegjëse për hapa të ndryshëm në procesin e dhënies së lejeve të ndërtimit.

Gjithsesi, shërbimi e-leje në portalin e-albania ka qenë funksional dhe përdorej nga palët e interesuar që nga data 1 shtator 2016. Në fund të 2017 ky sistem ishte përdorur 40 mijë herë dhe kishte të regjistruar mbi 12 mijë aplikime për shërbime të ndryshme (shërbimi e-leje ofro 19 lloje të ndryshme aplikimesh).⁴ Po ashtu, shërbimi e-leje nuk përfshin arkivë digjitale siç përshkruhet në këtë angazhim dhe as nuk krijon mundësi për publikimi e shërbimeve teknologjike dhe infrastrukurore. Edhe pse përfaqësuesi nga Arkivi Qendror Teknik i Ndërtimit i intervistuar nga hulumtuesi MRP sugjeroi se mund të jetë e njëjta gjë,⁵ është e paqartë nëse e-leje është e lidhur me Arkivin Digjital siç përshkruhet në këtë angazhim.

A mundësoi qeverisje të hapur?

Aksesi tek informacioni: Nuk ndryshoi

Pjesëmarrja qytetare: Nuk ndryshoi

Llogaridhënia publike: Nuk ndryshoi

Zbatimi shumë i kufizuar i këtij angazhim nuk ka sjellë ndonjë ndryshim në hapjen e qeverisë.

Hapat e mëtejshëm

Në kohën kur po përgatitej ky raport, Shqipëria nuk e kishte publikuar ende planin e ri të veprimit. Duke pasur parasysh mungesën e lidhjes së këtij angazhimi me vlerat PQH sipas mënyrës së përshkrimit të tij, hulumtuesi MRP sugjeron që ky angazhim të vazhdojë edhe në planin tjetër të veprimit nëse i siguron publikut akses te baza e digjitalizuar e të dhënave të Arkivit Qendror Teknik të Ndërtimit dhe jo thjesht akses nëpërmjet kërkesës së një pale të interesuar.

¹ Për më shumë informacione referojuni Raportit të Progresit të Shqipërisë nga MRP 2016-2017. Intervistat u kryen në shtator 2017.

² Arkivi Teknik Qendror i Ndërtimit, <http://www.aqtn.gov.al/index.php>

³ e-leje – Aplikime për leje ndërtimi, https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=6093

⁴ Raport i AKSHI 2017, faqe 61, <http://akshi.gov.al/wp-content/uploads/2018/04/raporti-vjetor-2017-AKSHI.pdf>

⁵ Zyrtar i Arkivit Teknik Qendror të Ndërtimit, intervistë nga Hulumtuesi MRP, 30 tetor 2018.

6. Baza e të dhënave të kërkimeve shkencore

Teksti i angazhimit:

Titulli: Krijimi i një baze të dhënash për arkivimin dhe publikimin e fondeve dhe programeve të kërkimit në Shqipëri

Në Shqipëri ka fare pak (ose aspak) bashkëpunim mes komunitetit shkencor dhe sektorit privat si dhe mes komunitetit shkencor dhe institucioneve publike në lidhje me hartimin e politikave të bazuara në dëshmi. Një nga pasojat kryesore negative është mungesa e rezultateve të hulumtimeve të prodhuara në Shqipëri. Aktualisht, ka një sërë programesh në vend (me financim publik ose nga fondet e donatorëve) që mbështesin kërkimet. Por mungesa e një portali unik, i cili të përmbajë të gjitha rezultatet e kërkimeve dhe thirrjeve, pengon zhvillimin e këtij bashkëpunimi.

Qeveria shqiptare do të angazhohet që të maksimizojë aksesin tek informacionet lidhur me hulumtimet e financuara nga fondet publike dhe private për të nxitur një bashkëpunim më të madh mes komunitetit shkencor, institucioneve publike dhe sektorit privat. Aktivitetet e propozuara në këtë kontekst janë si më poshtë:

- Hartimi, miratimi dhe promovimi i standardeve të hapura për shkencën në Shqipëri.
- Zbatimi i legjislacionit nëpërmjet një akti nënligjor për të mundësuar kërkimin me një ndalesë për botimet dhe të dhënat që rezultojnë nga puna shkencore e ndërmarrë nga institucionet dhe studiuesit shqiptarë (të mbështetur nga burime shqiptare dhe burime të tjera financimi).

Institucioni përgjegjës: Ministria e Arsimit dhe Sportit

Institucion(et) mbështetës(e): Agjencia për Kërkime, Teknologji dhe Inovacion (ARTI); Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM)

Data e fillimit: 2016

Data e mbarimit: 2018

Përmbledhje e angazhimit	Detajimi				Lidhja me vlerën PQH (siç shkruhet)				Ndikimi i mundshëm				Zbatimi		Afat-mesëm Përfundimtar		A mundësoi qeverisje të hapur?				
	Nuk ka	I ulët	Mesatar	I lartë	Akresi në Informacion	Pjesëmarrja qytetare	Llogaridhënia publike	Tek. e Inov. për transp. e llogaridhën.	Nuk ka	I vogël	Mesatar	Transformues	Nuk ka filluar ende	I kufizuar	I konsiderueshëm	I përfunduar	E përkeqësoi	Nuk e ndryshoi	Paksa	Konsiderueshëm	Jashtëzakonisht shumë
6. Baza e të dhënave të kërkimeve shkencore				✓	✓		✓				✓		✓				✓				

Synimi i angazhimit

Ky angazhim kishte si synim të nxiste një kulturë hartimi politikash bazuar në evidenca duke angazhuar burimet kërkimore dhe ndarjen e rezultateve të kërkimit në një faqe unike në internet. Pritet që ky objektiv të arrihet me anë të ndërmarrjes së dy hapave: e para është hartimi, miratimi

dhe promovimi i standardeve të hapura për shkencën; e dyta ishte hartimi i legjislacionit për të mundësuar portalin me një dalje për kërkimet për të dhëna dhe botime shkencore dhe rrjedhimisht krijimi i portalit.

Zbatimi

Periudha afatmesme: Nuk ka filluar ende

Zbatimi i këtij angazhimi nuk kishte nisur ende në periudhën afatmesme. Sipas Ligjit “për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor” dhe VKM “Për ngritjen, përbërjen dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit” që nga muaji gushti 2016 Agjencia Kombëtare për Teknologjinë dhe Inovacionin (AKTI) u riemërtua si Agjencia Kombëtare për Kërkimin Shkencor dhe Inovacionin (AKKSHI) dhe kaloi në varësi të Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve. Agjencia u përball me sfida mjaft të mëdha për sa i përket burimeve njerëzore dhe infrastrukturës duke e pasur të vështirë të përmbushte detyrat e veta.¹

Edhe pse Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM) listohet si institucion mbështetës, kjo organizatë nuk pati asnjë përfshirje në këtë angazhim.

Periudha përfundimtare: i kufizuar

Ministria e arsimit, sportit dhe rinisë (MASR) raportoi progress në ndërtimin e kuadrit rregullator për vlerësimin e cilësisë së hulumtimit shkencor, me miratimin e vendimit të Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 165, datë 21 Mars 2018.² Ky vendim shpjegon metodologjinë e vlerësimit të aktivitetit hulumtues shkencor në institucionet e arsimit të lartë dhe të përkufizimit të kriterëve vlerësues. Megjithatë, në mënyrë që kjo procedure të zbatohet, duhet të plotësohet nga dy masa të parashikuara në VKM: përcaktimi i sistemit algoritmik dhe krijimit të Sistemit informative shqiptar të hulumtimit shkencor (ACRIS) për të shërbyer si bazë të dhënash kombëtare.³

Ministria gjithashtu raportoi krijimin e një platforme për Bibliotekën digjitale universitare (ulibrary.rash.al) si pjesë e Paktit për Universitetin. Prej fillimit të 2019ës platforma u mundëson akses studentëve dhe stafit të institucioneve të arsimit të lartë në punime shkencore të institucioneve të tilla. Hapa po ndërmerren edhe për krijimin e databasës së dizertacioneve digjitale e cila do të mundësojë software kundër plagjiaturës në zbatim të VKM nr 777, datë 26 Dhjetor 2018.⁴⁵

A mundësoi qeverisje të hapur?

Aksesi tek informacioni: Nuk ndryshoi

Zbatimi i këtij angazhim mbeti i kufizuar, ndaj këtij angazhimi nuk mund t’i atribuohet asnjë ndryshim për sa i përket aksesit në informacion.

Hapat e mëtejshëm

Në kohën kur po përgatitej ky raport, plani i ri i veprimit nuk ishte publikuar ende. Nëse kjo çështje do të bëhej prioritarë në planet e ardhshme të veprimit, MAS dhe AKKSHI duhet të nisin me miratimin e një dokumenti ligjor dhe politikash për shkencën e hapur në përputhje me rekomandimin e Komisionit Evropian të vitit 2012, që ka të bëjë me përfshirjen e një kuadri institucional që do të bënte të mundur një bazë të dhënash online për të dhëna shkencore dhe hulumtime të aplikuara të prodhuara në Shqipëri. Për më tepër, angazhimi në këtë fushë do të lidhej edhe me përfshirjen e institucioneve përkatëse, si universitetet, organizatat kërkimore, dhe shoqatat e biznesit, që kryejnë, mes të tjerash, edhe hulumtime.

¹ Raporti i Progresit të Shqipërisë nga MRP 2016-2017, faqe 53,

https://www.opengovpartnership.org/sites/default/files/Albania_Mid-Term_2016-2018_EN_for-pub-comm.pdf

² VKM e aksesueshme në faqen e Qeverisë <http://www1.kryeministria.al/newsroom/vendime-te-miratuara-ne-mbledhjen-e-keshillit-te-ministrave-date-21-mars-2018/>

³ Informacion i ofruar nga MASR gjatë periudhës së para-publikimit të këtij raporti (Korrik 2019).

⁴ VKM e aksesueshme në faqen e Qeverisë <http://www1.kryeministria.al/newsroom/vendime-te-miratuara-ne-mbledhjen-e-keshillit-te-ministrave-date-26-dhjetor-2018/>

⁵ Informacion i ofruar nga MASR gjatë periudhës së para-publikimit të këtij raporti (Korrik 2019).

7. Publikimi në internet i legjislacionit të qeverisë

Teksti i angazhimit:

Titulli: Publikimi në internet i legjislacionit në nivel qendror dhe vendor në sistemet e hapura dhe falas

Organizata Infocip mendon se aksesit tek legjislacioni qendror dhe vendor është një shërbim publik që nuk ka nevojë për përmirësime, pavarësisht kërkesave të qarta ligjore.

Angazhimi për publikimin në internet në sisteme të hapura dhe falas të legjislacionit kombëtar dhe vendor përfshin:

- Në lidhje me legjislacionin qendror, qeveria është e angazhuar për publikimin e legjislacionit në faqet zyrtare të ministrive të linjës, pa pagesë, në rubrikën "Legjislacioni"
- Në lidhje me legjislacionin vendor, Infocip ofron vendime.al si një platformë kombëtare online, unike në llojin e vet, që mund të përshtatet si mekanizëm raportimi.

Institucioni përgjegjës: Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore (MSHCV)

Institucion(et) mbështetës(e): InfoCip

Data e fillimit: 2016

Data e mbarimit: 2018

Shënim redaksional: Për të lexuar të gjithë tekstin e angazhimit, lutemi referojuni

https://www.opengovpartnership.org/sites/default/files/Albania_NAP3_ENG.pdf.

Përmbledhje e angazhimit	Detajimi				Lidhja me vlerën PQH (siç shkruhet)				Ndikimi i mundshëm				Zbatimi		Afat-mesëm Përfundimtar		A mundësoi qeverisje të hapur?				
	Nuk ka	I ulët	Mesatar	I lartë	Akresi në Informacion	Pjesëmarrja qytetare	Ulogaridhënia publike	Tek. e Inov. për transp. e llogaridhën.	Nuk ka	I vogël	Mesatar	Transformues	Nuk ka filluar ende	I kufizuar	I konsiderueshëm	I përfunduar	E përkeqësoi	Nuk e ndryshoi	Paksa	Konsiderueshëm	Jashtëzakonisht shumë
7. Publikimi në internet i legjislacionit të qeverisë			✓		✓						✓		✓							✓	

Synimi i angazhimit

Ky angazhim kishte si synim përmirësimin e aksesit tek legjislacioni kombëtar dhe vendor. Në nivel vendor edhe pse aksesit në legjislacion bëhej i mundur sipas dispozitave ligjore, legjislacioni i qeverisë vendore shpesh nuk bëhej publik, pjesërisht për faktin se bashkitë nuk kishin faqe zyrtare në internet. Në mënyrë të veçantë, bashkitë në qendrat e mëdha urbane dhe në zonat e zhvilluara të vendit i botonin rregullisht vendimet e tyre në faqet zyrtare ose nëpërmjet mjeteve të tjera. Megjithatë, bashkitë e vogla apo të mesme nuk i botojnë vendimet e tyre në internet. Në nivel qendror, edhe sistemi i publikimit të legjislacionit të qeverisë ishte i fragmentuar dhe joefikas, ndonëse aktet ligjore

dhe nënligjore të miratuara nga qeveria qendrore duhet të botohen në Fletoren Zyrtare dhe në portalin <http://www.qbz.gov.al>.

Me sugjerim të organizatës INFOÇIP, qeveria shqiptare u angazhua për të publikuar në internet legjislacionin kombëtar e vendor në format të dhënat të hapura dhe falas. Ky angazhim përbëhet nga dy hapa: së pari, ligjet e qeverisë qendrore, aktet nënligjore dhe akte të tjera ligjore të miratuara nga institucionet do të botoheshin në faqen zyrtare të çdo ministrie. Së dyti, për njësitë e qeverisjes vendore, angazhimi ofroi portalin vendime.al si platformë online dhe si një mekanizëm të mundshëm raportimi.

Zbatimi

Periudha afatmesme: I kufizuar

Ky angazhim kishte progres të kufizuar në periudhën afatmesme. Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore (MSHÇV), institucion drejtues, nuk ishte në dijeni të përgjegjësive të tij në lidhje me këtë angazhim. Qendra për Çështjet e Informimit Publik (e njohur si INFOÇIP)¹, e listuar si institucion mbështetës, veprroi në fakt si organizata kryesore zbatuese. Po ashtu, MSHÇV nuk ishte në dijeni se ishte angazhuar për të publikuar legjislacionin e qeverisë qendrore në faqet zyrtare të ministrive të linjës dhe në Fletoren Zyrtare.

INFOCIP raportoi se vendime.al e kishte rritur numrin e bashkive që publikonin vendimet e tyre në këtë portal. Raporti afatmesëm i MRP 2016-2017 evidentonte një numër të vogël përdoruesish të portalit vendime.al.²

Periudha përfundimtare: I konsiderueshëm

Nuk u konstatua progres në 2018 për sa i përket arritjes së objektivit të parë të këtij angazhimi, publikimi falas i legjislacionit të qeverisë qendrore në faqet zyrtare të ministrive të linjës. Faqet zyrtare të ministrive kanë një seksion të quajtur “legjislacioni”, ku gjenden informacione për aktet ligjore dhe nënligjore që rregullojnë sektorë nën kompetencë të tyre, ndonëse jo të gjitha këto faqe janë të plota. D.m.th., ka mungesë të informacionit të përditësuar për aktet nënligjore të miratuara, si urdhra, vendime, apo udhëzime të ministrive.

Megjithatë, objektivi i dytë, publikimi në internet në portalin vendime.al i të gjitha vendimeve të NJQV-ve në të gjithë vendin u zbatua plotësisht.³ INFOCIP raportoi se të 61 bashkitë e vendit i publikuan vendimet e tyre në këtë portal. Në vitin 2016 vetëm 12 bashki publikonin vendimet e tyre; në 2017 ky numër u rrit në 41 bashki. Gjatë vitit 2018, falë edhe mbështetjes nga projekt STAR i financuar nga PNUD, INFOCIP i përfshiu të 61 by në portalin vendime.al.⁴

A mundësoi qeverisje të hapur?

Aksesi tek informacioni: Konsiderueshëm

Edhe pse qeveria qendrore nuk publikoi në faqet zyrtare legjislacionin e saj, publikimi online i të gjitha vendimeve të NJQV-ve në të gjithë vendin në portalin vendime.al përbën një arritje të madhe. Në fakt, aksesi i publikut të vendimet e bashkive kishte qenë problem për një kohët të gjatë. Prandaj, ky portal ofron përgjigjen e duhur ndaj kësaj nevojë dhe rezultatet paraprake të përdorimit të këtij portali janë inkurajuese. OSHC-të, veçanërisht në bashkitë e vogla e të pazhvilluara, e konsiderojnë këtë portal tejet të dobishëm në punën e tyre.⁵

Në portalin vendime.al janë publikuar plot 20,662 vendime të këshillave bashkiakë, që i përkasin 61 bashkive. Që nga hapja e këtij portali në vitin 2013, numri i vizitorëve të tij ka arritur në shifrën 142,785. Numri i vizitorëve është rritur nga rreth 11,000 në vitin 2013 në 81,000 në 2018. Deri në nëntor 2018, në këtë platformë të unifikuar me qëllim leximin/shkarkimin e vendimeve të këshillave bashkiakë janë bërë rreth 10 milionë klikime (9,884,833) dhe janë shfletuar në total 3,370,495 faqe nga përdorues të ndryshëm. Këto të dhëna janë rritur përkatësisht nga 60,000 klikime dhe 241,000 faqe në 2013 në rreth 4 milionë klikime dhe 1.5 milionë faqe në 2018. Po ashtu, përfaqësues të

INFOCIP sugjerojnë se numri i përfituesve të informacionit të publikuar pritet të vazhdojë të rritet ndjeshëm.⁶

Hapat e mëtejshëm

Në kohën kur po përgatitej ky raport, Shqipëria nuk e kishte publikuar ende planin e ri të veprimit. Hapi i mëpashtëm në këtë angazhim, siç rekomandohet nga Hulamtuesi MRP, mund të ishte unifikimi i të gjitha faqeve zyrtare të ministrive me seksion të veçantë “legjislativ”. E njëjta gjë mund të aplikohet edhe për agjencitë e tjera shtetërore në nivel qeverie qendrore.

¹ INFOCIP, <http://www.infocip.org/en/>

² Raporti i Progresit të Shqipërisë nga MRP 2016-2017, faqe 56.

³ Gert Shella, Drejtor i INFOCIP, intervistë nga Hulamtuesi MRP, 31 tetor 2018.

⁴ Raport për zbatimin e të drejtës së informimit nga bashkitë në Shqipëri (shtator 2018), faqe 19, <http://www.infocip.org/al/wp-content/uploads/2018/09/Monitorimi-INFOCIP-2018-E-DREJTA-E-INFORMIMITNE-6IBASHKI.pdf>

⁵ Dëshmi e aktivistëve të shoqërisë civile për dobinë e portalit Vendime.al, https://www.facebook.com/story.php?story_fbid=2160148487377249&id=302120716513378&refid=52&__tn__=C-R

⁶ Gert Shella, Drejtor i INFOCIP, intervistë nga Hulamtuesi MRP, 31 tetor 2018.

8. Regjistri elektronik i koncesioneve

Teksti i angazhimit:

Titulli: standarde të hapura për kontraktimin, kontratat publike të publikohen në format të dhënash të hapura

Organizata “Instituti Shqiptar i Shkencave” (ISHSH) është organizatë që promovon të dhëna të hapura dhe transparencë, e angazhuar njëkohësisht edhe si anëtare e Koalicionit për Partneritetin e Qeverisjes së Hapur për Shqipërinë. Në këtë aspekt, ISHSH propozoi disa angazhime për qeverinë dhe partnerët e saj për t’u përfshirë në planin kombëtar të veprimit 2016-2018, përfshirë këtu publikimin online të kontratave të koncesionit dhe PPP në të cilat bën pjesë edhe Qeveria.

Institucioni shtetëror i përfshirë në këtë angazhim është Ministria e Ekonomisë, Zhvillimit, Tregtisë, Turizmit dhe Sipërmarrjes.

Qeveria shqiptare është e angazhuar për përdorimin e standardeve të hapura për kontraktim. Shtetet dhe aktorët kryesorë janë aktualisht të prirur për të bërë përpjekjeve për të pasur akses tek informacionet në lidhje me kontratat publike dhe për ecurinë e tyre deri në përfundimin e këtyre kontratave. Regjistri i Koncesionarëve duhet të ndërtohet në bazë të Ligjit “Për Koncesione dhe PPP”, dhe VKM vlerësohet të ofrojë një format të hapur të dhënash duke siguruar kështu edhe sekretin tregtar apo intelektual. Agjencia e Trajtitimit të Koncesioneve ka ndërmarrë këtë angazhim për të krijuar Regjistrin Elektronik të Koncesioneve dhe Partneritetit Publik-Privat sipas Ligjit nr. 125/2013, i ndryshuar, dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 211, datë 16.03.2016 “Për krijimin dhe administrimin e Regjistrit Elektronik të Koncesioneve/PPP”.

Ky institucion është aktualisht në procesin e mbledhjes së të dhënave për të gjitha kontratat dhe koncesionet PPP nga të gjitha autoritetet kontraktuese në Republikën e Shqipërisë. Baza e të dhënave që do të krijohet si rezultat i këtij angazhimi do të jetë publik dhe i aksesueshëm për të gjithë.

Institucioni përgjegjës: Ministria e Ekonomisë, Zhvillimit, Tregtisë, Turizmit dhe Sipërmarrjes/Agjencia e Trajtitimit të Koncesioneve

Institucion(et) mbështetës(e): Instituti Shqiptar i Shkencave

Data e fillimit: 2016

Data e mbarimit: 2018

Përmbledhje e angazhimit	Detajimi				Lidhja me vlerën PQH (siç shkruhet)				Ndikimi i mundshëm				Zbatimi		Afat-mesëm Përfundimtar		A mundësoi qeverisje të hapur?				
	Nuk ka	I ulët	Mesatar	I lartë	Akresi në Informacion	Pjesëmarrja qytetare	Llogaridhënia publike	Tek. e Inov. për transp. e llogaridhën.	Nuk ka	I vogël	Mesatar	Transformues	Nuk ka filluar ende	I kufizuar	I konsiderueshëm	I përfunduar	E përkeqësoi	Nuk e ndryshoi	Paksa	Konsiderueshëm	Jashtëzakonisht shumë
8. Regjistri elektronik i koncesioneve		✓			✓		✓				✓			✓					✓		

Synimi i angazhimit

Ky angazhim kishte si synim përmirësimin e aksesit tek informacioni dhe mbikëqyrjen nga publiku të prokurimit publik duke krijuar një regjistër elektronik të koncesioneve dhe partneriteteve publike-private (regjistri i koncesionarëve). Regjistri kishte si pikësynim të mblidhte të dhëna për të gjitha koncesionet dhe kontratat PPP në Shqipëri dhe të prodhonte një bazë të dhënash të aksesueshëm nga publiku.

Zbatimi

Periudha afatmesme: I kufizuar

Regjistri i Koncesioneve dhe PPP-ve nisi në fund të vitit 2016 nga Agjencia e Trajtimit të Koncesioneve.¹ Nuk u bënë konsultime me shoqërinë civile, median, apo grupet e tjera të interesit në zbatimin e këtij angazhimi PQH. Në kohën e përgatitjes së këtij raporti, jo të gjitha kontratat ishin publikuar në regjistër dhe informacioni i dhënë nuk ishte në formatin e të dhënave të hapura. Rrjedhimisht, Regjistri nuk ka bërë të mundur më shumë transparencë mbi koncesionet e dhëna. Burime të ndryshme të medias dhe grupe të shoqërisë civile, si Open Data Albania, vazhdojnë të ngrenë shqetësime lidhur me mungesën e informacioneve për koncesionet dhe PPP-të.²

Periudha përfundimtare: I konsiderueshëm

Në vitin e fundit, Agjencia e Trajtimit të Koncesioneve krijoi një bazë të dhënash për 235 koncesione deri në tetor 2018.³ Në vitin 2017 vetëm 15 koncesione ishin regjistruar në këtë portal. Më shumë se 90% e zërave të regjistrit elektronik kishin informacione për koncesionet dhe kontratat e tyre, dhe 10% i mbetur lidhej me informacione për amendimet në kontratat ekzistuese për koncesione. Pjesa më e madhe e koncesioneve të publikuara janë ato që janë kontraktuar para vitit 2013, ndërsa rreth 20% e koncesioneve të publikuara janë të periudhës 2014 dhe 2018. Regjistri elektronik përmban të dhëna për datën e nënshkrimit të koncesionit, llojin e kontratës, shumën e investuar, tarifën, kohëzgjatjen (në vite), fushën e operimit (sektori), çmimin, vendndodhjen, dhe një përshkrim të shkurtër si dhe palët nënshkruese (aktorë të sektorit privat dhe atij shtetëror). Në çdo zë të është publikuar edhe kontrata e firmosur e koncesionit. Regjistri ka edhe raporte të veçanta (të dhëna të paraqitura në grafikë) ku jepen të dhëna të detajuara për koncesionet e firmosura sipas sektorëve,⁴ vitit të nënshkrimit,⁵ autoritetit kontraktues,⁶ operatorëve të sektorit privat (të cilëve u është akorduar koncesioni),⁷ shuma e investuar,⁸ dhe një krahasim të çmimit me investimin.⁹ Megjithatë, informacioni i paraqitur nuk është në formatin e të dhënave të hapura, siç parashikohet edhe nga plani i veprimit.

A mundësoi qeverisje të hapur?

Aksesi tek informacioni: I vogël

Edhe pse publikimi i informacionit për më shumë se 200 koncesione përfaqëson një zhvillim të rëndësishëm, pak bëhet e njohur për publikun dhe aktorët e interesuar (p.sh., media, shoqëria civile) për vlerën totale të koncesioneve dhe performancën e tyre çdo vit – p.sh., taksat që kanë paguar, fitime, përfitimi i publikut e kështu me radhë. E njëjta gjë ndodh me PPP-të, ose procedura nëpërmjet të cilës u akordua. Banka Botërore vuri theksin për sa më sipër, në prill 2018, dhe për disa shqetësime të tjera që lidhen me PPP-të në Shqipëri, duke i kërkuar qeverisë të forcojë transparencën, integritetin e procedurave, rreziqet e korrupsionit, mënyrën e vlerësimit të tyre dhe administrimin e zbatimit të tyre, përfshirë këtu monitorimin dhe çështje të tjera që lidhen me to.¹⁰ Edhe Fondi Monetar Ndërkombëtar ngriti shqetësime për PPP-të në Shqipëri në fillim të këtij viti, duke e këshilluar qeverinë të veprojë me kujdes me programin e saj I miliardë euro.¹¹

Edhe pse media mund t'i përdorë të dhënat e publikuara në regjistrin, për monitorim sa më efikas do të duhet që portali të ketë të dhëna më të dobishme e të përditësuara për PPP-të dhe koncesionet të publikuara nga aktorët shtetërorë. Si përfundim, zbatimi i pjesshëm i këtij angazhimi, për shkak të

mungesës së formatit të të dhënave të hapura të informacionit të publikuar, ka rritur fare pak aksesin tek informacioni.

Hapat e mëtejshëm

Në kohën kur po përgatitej ky raport, plani i ri i veprimit nuk ishte publikuar ende nga qeveria qendrore. Hulumtuesi MRP rekomandon që qeveria të bëjë konsultime me shoqërinë civile, median dhe grupet e tjera të interesit për të përmirësuar regjistrin aktual. Mund të merren në konsideratë edhe rekomandimet e mëposhtme:

- Të rritet cilësia e të dhënave për secilin koncesion dhe PPP në format të dhënash të hapura në përputhje me Standardin e të Dhënave të Hapura për Kontratat;
- Të lidhet Regjistri me procesin e ankimit të Komisionit të Prokurimit Publik;
- Të forcohet sistemi i performancës dhe i monitorimit të respektimit të prokurimit elektronik si dhe të bëhet i mundur raportimi për publikun dhe monitorimi i performancës.
- Të harmonizohet më shumë me rregullat e prokurimit publik të BE-së, duke përfshirë rekomandimet për një regjistër kontratash për të gjitha kontratat publike dhe përmirësimet në proceset e dhënies së koncesioneve dhe menaxhimit dhe prokurimit të mbrojtjes;
- Me përafrimin e mëtejshëm të kuadrit ligjor dhe me përmirësimin e akteve nënligjore që rregullojnë Regjistrin duhet të trajtohen shqetësimet e shoqërisë civile mbi dobinë e informacionit të Regjistrit dhe sasinë e informacionit që ofrohet në portal. Ndryshime të tilla duhet të përfshijnë aspekte që lidhen me formatin e informacionit (në të dhëna të hapura), llojin e informacionit (p.sh. të ardhurat, taksat e mbledhura) dhe aspekte të tjera që nuk janë të përcaktuara dhe të cilat do të bënin ndryshimin e vërtetë.

¹ Regjistri i koncesioneve dhe PPP-ve, http://www.atrako.gov.al/?faqe_id=112

² Gazeta Shekulli, 20 korrik 2017, <http://open.data.al/sq/lajme/lajm/lang/sq/id/1953/titull/Pesekonkesionetfshehtateqeverisegjatekoheshezgjedhjeve/Pese-konkesionet-e-fshehta-te-qeverise-gjate-kohes-se-zgjedhjeve>

³ Regjistri i koncesioneve dhe PPP-ve, http://www.atrako.gov.al/?faqe_id=112.

⁴ Grafiku për kontratat sipas fushës së veprimtarisë, http://www.atrako.gov.al/?faqe_id=638

⁵ Grafiku për kontratat vjetore, http://www.atrako.gov.al/?faqe_id=640

⁶ Grafiku për kontratat sipas autoritetit kontraktual, http://www.atrako.gov.al/?faqe_id=642

⁷ Grafiku për kontratat sipas partnerit privat të kontraktuar, http://www.atrako.gov.al/?faqe_id=644

⁸ Grafiku për kontratat sipas vlerës monetare, http://www.atrako.gov.al/?faqe_id=646

⁹ Grafiku për kontratat sipas raportit të vlerës monetare të investimit dhe çmimit, http://www.atrako.gov.al/?faqe_id=648

¹⁰ Oranews TV, “Banka Botërore tregon kush janë rreziqet që mund të vijnë nga PPP?”, prill 2018, <http://www.oranews.tv/article/banka-boterore-tregon-kush-jane-rreziqet-qe-mund-te-vijne-nga-ppp>

¹¹ Jens Reinke, Drejtor i Zyrës së FMN në Tiranë, intervistë për Top-Channel, mars 2018 “FMN: Qeveria të pezullojë përkohësisht koncesionet, stop propozimeve të pakërkuara nga privatët”, <http://www.javanews.al/fmn-qeveria-te-pezulloje-perkohesisht-konkesionet-stop-propozimeve-te-pakerkuara-nga-privatet/>

✪9. Zbatimi i Ligjit për Sinjalizimet dhe Mbrojtjen e Sinjalizuesve

Teksti i angazhimit:

Titulli: Zbatimi i Ligjit për Sinjalizimet dhe Mbrojtjen e Sinjalizuesve, ngritje kapacitetesh, ndryshime ligjore dhe aktet nënligjore

Në maj të vitit 2014, Koordinator i Kombëtar i Anti-korrupsionit dhe Ministria e Drejtësisë, me ndihmën e qeverisë holandeze që u kanalizua përmes Universitetit të Utrehtit, filloi hartimin e ligjit “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”. Ky ligj shërben për të rritur transparencën e institucioneve publike dhe private duke krijuar një ambient më të mirë që punonjësit të denoncojnë rastet e korrupsionit.

Ligji përcakton veprat e lidhura me korrupsionin, përcakton kompetencat e mekanizmeve të brendshëm si dhe përcakton se cili organ duhet të shërbejë si mekanizëm i raportimit të jashtëm dhe se si duhet të sigurohet mbrojtja e sinjalizuesve. Përveç kësaj, ligji zbatohet si për sektorin publik ashtu edhe për atë privat. Ai u miratua në Kuvend më 2 qershor 2016. Me Dekretin e Presidentit të Republikës nr. 9647, datë 20.06.2016, ligji u botua në Fletoren Zyrtare Nr. 115 më 23 qershor 2016 dhe hyri në fuqi më 8 korrik 2016. Efektet e tij ligjore zgjasin nga 1 tetori 2016 me përjashtim të efekteve juridike për keqtrajtimin e brendshëm për subjektet private, të cilat fillojnë më 1 korrik 2017 (Shënim: Ky ishte një angazhim i planit të dytë kombëtar të veprimit 2014-2016).

Objektivat për këtë angazhim në planin kombëtar të veprimit:

- Hartimi i akteve nënligjore, udhëzimeve përkatëse dhe formave të raportimit për ndjekjen dhe hetimin nga ana e ILDKPKI-së për zbatimin e suksesshëm të këtij ligji;*
- Konsultimet me palët e interesuara në Tiranë dhe rrethe të tjera për futjen e akteve nënligjore, konsultimet dhe rekomandimet e tyre;*
- Ngritja e kapaciteteve përmes trajnimeve dhe asistencës teknike për stafin e ILDKPKI-së dhe të personelit tjetër të administratës publike për zbatimin e suksesshëm të ligjit, akteve nënligjore dhe rregulloreve, përgatitjen e përshkrimit të vendeve të punës për personelin përgjegjës për marrjen e sinjalizimeve dhe ndjekjes së tyre;*
- Fushata ndërgjegjësimi dhe edukimi në media për ligjin dhe rëndësinë e zbatimit të tij në luftën kundër korrupsionit.*

Institucioni përgjegjës: Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore (MSHÇV)

Institucion(et) mbështetës(e): Partnerët Shqipëri, media, bizneset

Data e fillimit: 2016

Data e mbarimit: 2018

Shënim redaksional: Për të lexuar të gjithë tekstin e angazhimit, lutemi referojuni

https://www.opengovpartnership.org/sites/default/files/Albania_NAP3_ENG.pdf

Përmbledhje e angazhimit	Detajimi	Lidhja me vlerën PQH (siç shkruhet)	Ndikimi i mundshëm	Zbatimi	Afat-mesëm Për-fundimtar	A mundësoi qeverisje të hapur?
--------------------------	----------	-------------------------------------	--------------------	---------	-----------------------------	--------------------------------

	Nuk ka	I ulët	Mesatar	I lartë	Akresi në Informacion	Pjesëmarrja qytetare	Llogaridhënia publike	Tek. e Inov. për transp. e llogaridhën.	Nuk ka	I vogël	Mesatar	Transformues	Nuk ka filluar ende	I kufizuar	I konsiderueshëm	I përfunduar	E përkeqësoi	Nuk e ndryshoi	Paksa	Konsiderueshëm	Jashtëzakonisht shumë
9. Zbatimi i Ligjit për Sinjalizimet dhe Mbrojtjen e Sinjalizuesve				✓	✓	✓	✓					✓				✓			✓		

Shënim redaksional: Ky angazhim është i matshëm, me lidhje të qartë me vlerat PQH ashtu siç është shkruar, ka ndikim të mundshëm transformues, dhe zbatimi i tij është i konsiderueshëm ose i përfunduar

Synimi i angazhimit

Ky angazhim ka si qëllim të rrisë numrin e denoncimeve për rastet e korrupsionit tek autoritetet publike dhe të mbrojë sinjalizuesit. Për të arritur këtë qëllim angazhimi parashikon katër aktivitete: miratimin e akteve nënllore për të siguruar zbatimin e ligjit, konsultimin me aktorët kryesorë, përmirësimin e kapaciteteve të Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konflikteve të Interesit (ILDKPKI), institucionit mbikëqyrës; dhe ngritjen e ndërgjegjësimit për sinjalizimet. Këto aktivitete krijojnë mjedisin e nevojshëm dhe mekanizmat institucionalë për zbatimin e ligjit. Këto aktivitete synojnë të krijojnë mjedisin e nevojshëm dhe mekanizmat institucionalë për zbatimin efikas të ligjit për sa i përket parandalimit dhe ndjekjes së rasteve të korrupsionit.

Zbatimi

Periudha afatmesme: I përfunduar

Angazhim u zbatua në periudhën afatmesme. Një organizatë vendore, Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim (Partnerët Shqipëri), luajti një rol kryesor në zbatimin e këtij angazhimi nëpërmjet një projekti të mbështetur nga Ambasada e Holandës në Tiranë.¹ Për shembull, aktet nënllore u hartuan dhe zbatuan pas organizimit të konsultimeve publike nga Partnerët Shqipëri në shtator 2016 në 5 rajone të ndryshme, me 240 pjesëmarrës.^{2, 3} Konsultimet publike u koordinuan me ILDKPKI, Koordinatorin Kombëtar kundër Korrupsionit dhe Komisionerin për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Për sa i përket ngritjes së kapaciteteve, Partnerët Shqipëri dhe ILDKPKI organizuan një sërë trajnimesh. Raporti vjetor i ILDKPKI i 2016 theksonte se në këtë vit u përgatit kurrikula për një seri trajnimesh të trajnerëve.⁴ Partnerët Shqipëri kryen trajnime për stafin e ILDKPKI në vitin 2017. Ndërsa në Shkollën Shqiptare të Administratës Publike u organizua një trajnim për trajnerët.⁵ Në vitin 2017, Partnerët Shqipëri organizoi dy trajnime me rreth 80 punonjës nga njësitë përkatëse të institucioneve qendrore dhe vendore.

Në lidhje me rritjen e ndërgjegjësimit, MSHÇV organizoi dy fushata – një fushatë ndërgjegjësimi me anë të mediave tradicionale dhe sociale dhe krijoi postera të informimit publik në qytetet kryesore të vendit në korrik 2017. Aktivitetet e ndërgjegjësimit filluan në tetor 2016, paralelisht me hyrjen e ligjit në fuqi.⁶ Në mediat sociale dhe tradicionale u transmetua edhe një spot televiziv informativ.⁷

A mundësoi qeverisje të hapur?

Aksesi tek informacioni: Nuk ndryshoi

Pjesëmarrja qytetare: I vogël

Llogaridhënia publike: Nuk ndryshoi

Në vitin 2017, Shqipëria ngriti 163 njësi përgjegjëse për mbrojtjen e sinjalizuesve në institucionet publike dhe 446 në sektorin privat. ILDKPKI raportoi se 140 institucione të tjera dështuan në përmbushjen e këtij detyrimi në afatin e përcaktuar kohor. Edhe pse institucionet shtetërore dhe aktorët e tjerë janë fokusuar më së shumti në infrastrukturën ligjore dhe institucional për zbatimin e dispozitave ligjore, viti 2017 shënoi rezultatet e para të zbatimit të legjislacionit për mbrojtjen e sinjalizuesve. Kështu, ILDKPKI ka trajtuar tetë raste raportimi në institucionet shtetërore në 2017, gjë që tregon për ndryshime të vogla në praktikën shtetërore për pjesëmarrjen e qytetarëve në denoncimin e shkeljeve në institucionet që janë subjekt i këtij ligji.

Pavarësisht rëndësisë së këtij angazhimi në krijimin e një kuadri zyrtar për forcimin e luftës kundër korrupsioni dhe abuzimeve të tjera, zbatimi i tij nuk ka sjellë ndonjë rezultat për sa i përket ndryshimeve të dukshme për rritjen e aksesit të publikut tek informacioni në rastet e raportuara apo për praktikatat e ndryshuara të llogaridhënies publike.

Hapat e mëtejshëm

Në kohën kur po përgatitej ky raport, plani i ri i veprimit nuk ishte publikuar ende në Shqipëri. Duke pasur parasysh rëndësinë e ligjit për mbrojtjen e sinjalizuesve në luftën kundër korrupsionit, qeveria duhet të vazhdojë me aktivitetet për rritjen e ndërgjegjësimit dhe trajnimet përkatëse për zbatimin e ligjit. Në sajë të rezultateve pozitive për sa i përket konfigurimit ligjor dhe institucional, hapat e mëtejshëm mund të fokusohen në monitorim.

10. Ofrimi i shërbimeve elektronike

Teksti i angazhimit:

Ky angazhim synon të ofrojë shërbime përmes një sistemi të menaxhimit të formularëve elektronikë (e-forms). Ky sistem do t'i ndihmojë institucionet e përfshira në këtë angazhim të reduktojnë proceset e punës manuale me letër, gjë që është shumë më e ngadalshme sesa përpunimi elektronik i informacionit duke përdorur mjetet elektronike të komunikimit me qytetarët. Po ashtu, sistemi do t'i ndihmojë qytetarët dhe bizneset të ulin kohën e nevojshme për marrjen e shërbimeve. Koha e përpunimit të formularit reduktohet, sepse formularët elektronikë dorëzohen në format elektronik. Sistemi do të rrisë efikasitetin e punonjësve të qeverisë, të cilët do t'u shërbejnë qytetarëve më shpejt dhe më mirë.

Institucioni përgjegjës: Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit

Institucion(et) mbështetës(e): Ministrinë e linjës dhe institucionet e tyre të varësisë, autoritetet vendore, institucionet e pavarura. Në total, janë mbi 85 institucione që ofrojnë shërbime nëpërmjet portalit e-Albania.

Data e fillimit: 2016

Data e mbarimit: Dhjetor 2017

Shënim redaksional: Për të lexuar të gjithë tekstin e angazhimit, lutemi referojuni https://www.opengovpartnership.org/sites/default/files/Albania_NAP3_ENG.pdf.

Përmbledhje e angazhimit	Detajimi				Lidhja me vlerën PQH (siç shkruhet)				Ndikimi i mundshëm				Zbatimi		Afatmesëm Përfundimtar		A mundësoi qeverisje të hapur?				
	Nuk ka	I ulët	Mesatar	I lartë	Akresi në Informacion	Pjesëmarrja qytetare	Llogaridhënia publike	Tek. e Inov. për transp. e llogaridhën.	Nuk ka	I vogël	Mesatar	Transformues	Nuk ka filluar ende	I kufizuar	I konsiderueshëm	I përfunduar	E përkeqësoi	Nuk e ndryshoi	Paksa	Konsiderueshëm	Jashtëzakonisht shumë
10. Ofrimi i shërbimeve elektronike		✓			I paqartë					✓					✓				✓		

Synimi i angazhimit

Agjencia Kombëtare për Shoqërinë e Informacionit (AKSHI) u angazhua të ndërtonte një sistem të menaxhimit të formularëve elektronikë (e-forms) për të ndihmuar institucionet publike në uljen e numrit të dokumenteve dhe reduktimit të kohës që u duhet qytetarëve dhe bizneseve për të marrë shërbime. Ky angazhim premtonte të arrijë të paktën 390 shërbime elektronike.

Zbatimi

Periudha afatmesme: I përfunduar

Në periudhën afatmesme, 36 shërbime të Ministrisë së Jashtme janë digitalizuar dhe mund të merren në portalin e-Albania⁸ dhe në faqen zyrtare të Ministrisë nën seksionin “Shërbime Konsulllore Online”.⁹ Megjithatë, disa nga këto shërbime ofroheshin vetëm për emigrantët shqiptarë që jetojnë në Gjermani dhe Itali.¹⁰

Faqet zyrtare të përfaqësive diplomatike dhe konsullore të Shqipërisë anë standardizuar¹¹ dhe kanë edhe lidhje për të drejtuar vizitorët tek shërbimet konsullore elektronike.¹²

Shërbimet e-leje ofroreshin në portalin e-Albania në kohën e hartimit të planit të veprimit, por ky ishte rasti vetëm për njësitë e qeverisjes vendore që kanë të miratuar planet e përgjithshme vendore të territori.¹³ Deri në fund të vitit 2016, objektivi i përcaktuar në planin e veprimit prej 390 shërbimesh të digjitalizuara ishte arritur.¹⁴

A mundësoi qeverisje të hapur?

Aksesi tek informacioni: I vogël

Në shtator 2018, portali e-Albania ofronte 1,348 shërbime dhe numëronte mbi 2 milionë vizita në muaj, ndërkohë që shërbimet e tij janë përdorur rreth 460,000 herë në muaj. Numri i përdoruesve të regjistruar vazhdon të rritet ku në qershor 2018 ky numër ishte mbi gjysmë milioni. Për vitin 2017, AKSHI raportonte se pjesa më e madhe e përdoruesve të regjistruar dhe përdorimi i shërbimeve vinin nga Tirana (81%) dhe vetëm 19% e vizitave në portal vinin nga zonat e tjera të vendit. Duke pasur parasysh informacionin për rritjen e numrit të vizitave në portal, mund të raportojmë ndryshime të vogla pozitive për përmirësimin e aksesit tek informacioni në lidhje me shërbimet publike (mënyrën e përdorimit apo si të përfitojmë nga këto shërbime).

Hapat e mëtejshëm

Në kohën kur po përgatitej ky raport, plani i ri i veprimit nuk ishte publikuar ende në Shqipëri. Duke pasur parasysh ndikimin e tij të mundshëm në përmirësimin e transparencës së shërbimeve publike, Hulumtuesi MRP rekomandon vazhdimin e zgjerimit të shërbimeve elektronike në portalin e-Albania për sa i përket numrit të shërbimeve që ofrohen online si dhe të vendoset në lidhje e qartë mes këtij angazhimi dhe një objektivi të publikimit të informacionit për publikun.

¹ Shqyrtimi i dosjes së projektit u mundësua nga Partnerët Shqipëri. Përveç financimit nga Ambasada Holandeze, OJQ kishte një marrëveshje me Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale

² Deri në nëntor 2016, ishin miratuar të gjitha aktet nënligjore dhe rregulloret për të siguruar zbatimin e Ligjit "Për sinjalizimet dhe mbrojtjen e sinjalizuesve", si vijon: Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 816 datë 16 nëntor 2016 "Për strukturën, kriteret e përzgjedhjes dhe çështjet e punësimit të të punësuarve në njësitë e institucioneve publike përgjegjëse për zbatimin e Ligjit "Për sinjalizimet dhe mbrojtjen e sinjalizuesve"; Direktiva e ILDKPKI "Për strukturën, kriteret e përzgjedhjes dhe trajnimin e punonjësve në njësitë e institucioneve private përgjegjëse për zbatimin e Ligjit "Për sinjalizimet dhe mbrojtjen e sinjalizuesve"; Rregullorja e ILDKPKI mbi hetimin administrativ të kërkesës së paditësit për mbrojtje nga hakmarrja; Rregullorja e Brendshme e ILDKPKI mbi hetimin administrativ të rastit të sinjalizuesve dhe mbrojtjen e konfidentalitetit; Direktiva e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale "Për kushtet, kriteret për përpunimin e të dhënave personale dhe afatin kohor në zbatimin e ligjit nr. 60/2016" (shtator 2016).

³ Partnerët Shqipëri, <http://partnersalbania.org/News/konsultime-mbi-aktet-nenligjore-per-zbatimin-e-ligjit-per-sinjalizimin-dhe-mbrojtjen-e-sinjalizuesve/>; edhe faqja në Facebook e Partnerët Shqipëri, https://www.facebook.com/permalink.php?story_fbid=10154488726133955&id=46227243954

⁴ Raporti i ILDKPKI 2016, faqe 12, www.hidaa.gov.al/raportet/Raporti%20Vjetor%202016-%20ILDKPKI.docx

⁵ Në total në institucione qendrore dhe vendore u ngritën 155 njësi gjatë periudhës së raportimit, intervistë me Arjola Agollin, shtator 2017.

⁶ Zyrtar i ILDKPKI, intervistë nga Hulumtuesi MRP, shtator 2017.

⁷ Spot televiziv, <https://youtu.be/HzHMUqdQF0s>

⁸ Faqja zyrtare e Ministrisë së Jashtme, <http://punetejashtme.gov.al/sherbimet-konsullore-online/>

⁹ "SHKO-Shërbime Konsullore Online" <http://www.punetejashtme.gov.al/al/sherbime/sherbimet-konsullore-online>

¹⁰ Progresi i raportit MRP Shqipëri 2016-2017, <https://www.opengovpartnership.org/documents/albania-progress-report-2016-2018-public-comment>

¹¹ Përfaqësitë shqiptare në botë, <http://www.punetejashtme.gov.al/al/perfaqesite-diplomatike/perfaqesite-shqiptare-ne-bote> dhe <http://www.ambasadat.gov.al>

¹² Shërbimet E-konsullore të Ambasadës së Shqipërisë në Itali, <http://www.ambasadat.gov.al/italy/sq/sherbime-te-ambasadës>

¹³ Shërbimet e-leje, <http://gazeta-shqip.com/lajme/2016/02/25/lejet-e-ndertimit-online-hapat-per-te-aplikuar-ne-sistemin-e-ri/>

¹⁴ <http://akshi.gov.al/images/raporti%20vjetor%202016.pdf>; <https://e-albania.al/esherbimet.aspx>

II. Thjeshtimi i aplikimeve për leje ndërtimi

Teksti i angazhimit:

Titulli: Krijimi i sistemit shumëfunktional të centralizuar për lejet e ndërtimit

Ky angazhim parashikon krijimin e një sistemi shumëfunktional për të thjeshtuar procedurën e aplikimeve për leje ndërtimi dhe përpunimin e tyre duke u ofruar qytetarëve dhe bizneseve mundësinë për të aplikuar vetëm online për ato leje. Qëllimi i këtij projekti është ngritja e një sistemi shumëfunktional dhe i centralizuar për të thjeshtuar procedurat për aplikimin për licenca zhvillimi e ndërtimi, duke u ofruar qytetarëve dhe bizneseve mundësinë për të aplikuar në internet. Duke qenë një sistem i centralizuar ai ka për qëllim të aksesohet në mënyrë elektronike nga të gjitha njësitë e qeverisjes qendrore dhe të gjitha institucionet e tjera të përfshira në procesin e vendimmarrjes përmes llogarive përkatëse. Ky projekt ka për qëllim të zbatojë komunikimin elektronik midis regjistrit të Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit me të dhënat elektronike të institucioneve të tjera për të kontrolluar dhe/ose automatikisht revokuar të dhënat e aplikantëve përmes platformës së interoperabilitetit të qeverisë; si dhe të evidentojë statusin e aplikimit në çdo fazë të procedurës.

Kjo lloj lejeje ofrohet vetëm “jashtë linje” (offline) duke kërkuar që bizneset të marrin të dokumente shumta nga institucionet e tjera publike dhe të dorëzojnë çdo gjë në ambientet e Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit (me qendër në Tiranë). Ky proces përfshin përpjekje të mëdha dhe shumë kohë deri në dhënien e lejes.

Ky projekt ka për qëllim krijimin e regjistrit elektronik të komunikimit të AKPT-së me të dhënat elektronike të institucioneve të tjera për verifikimin ose automatizimin e bazës së të dhënave të aplikantëve, përmes platformës së interoperabilitetit të qeverisë dhe evidentimit të statusit të aplikimit në çdo fazë nëpërmjet sistemit eTracking. Po ashtu, ky projekt do të përshtatë regjistrin aktual sipas kërkesave të ndryshimeve të fundit ligjore. Sistemi do të futet për herë të parë në Shqipëri dhe do të përfshijë aplikacionin për aplikimet për leje zhvillimi përmes sistemit në internet. Ka shumë rëndësi bashkëpunimi i ngushtë me autoritetet vendore për të arritur këtë sistem shumëfunktional të centralizuar.

Institucioni përgjegjës: Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit

Institucion(et) mbështetës(e): Ministria e Zhvillimit Urban/ Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit, njësitë e qeverisjes vendore

Data e fillimit: 2016

Data e mbarimit: 2016

	Detajimi				Lidhja me vlerën PQH (siç shkruhet)	Ndikimi i mundshëm				Zbatimi		Afat-mesëm	A mundësoi qeverisje të hapur?						
	Nuk ka	I ulët	Mesatar	I lartë		Nuk ka	I vogël	Mesatar	Transformues	Nuk ka filluar ende	I kufizuar	I konsiderueshëm		I përfunduar					
Përmbledhje e angazhimit					Akresi në Informacion Pjesëmarrja qytetare Llogaridhënia publike Tek. e Inov. për transp. e llogaridhën.									E përkeqësoi	Nuk e ndryshoi	Paksa	Konsiderueshëm	Jashtëzakonisht shumë	
II. Thjeshtimi i aplikimeve për leje ndërtimi		✓			I paqartë		✓					✓		✓					

Synimi i angazhimit

Deri në fillim të vitit 2016, lejet e ndërtimit jepeshin vetëm “jashtë linje” (offline). Ky angazhim kishte si synim të vinte në zbatim komunikimin elektronik mes regjistrin të Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit (AKPT) dhe dosjeve elektronike të institucioneve të tjera publike, për të thjeshtuar menaxhimin e lejeve të ndërtimit. Ky sistem i centralizuar shumëfunktional do të përditësonte automatikisht të dhënat e aplikantëve, do të zhvendoste të dhënat përmes platformës së interoperabilitetit dhe do të evidentonte statusin e një aplikimi në çdo fazë të procedurës. Sipas planit të veprimit të PQH-së, ky projekt do të përshtatë edhe regjistrin aktual në përputhje me ndryshimet më të fundit ligjore. Kjo do të ishte hera e parë që në Shqipëri prezantohej një sistem i centralizuar për lejet e ndërtimit dhe që do të përkthente plotësisht aplikimin për leje në një platformë online.

Zbatimi

Periudha afatmesme: I përfunduar

AKSHI dhe AKPT e raportuan këtë projekt si të përfunduar.¹ AKPT nxori udhëzime për përdorimin e sistemit nga të interesuarit.² Në mars 2017 AKSHI raportoi se sistemi ofronte proces të informatizuar ku përfshihen të gjitha institucionet që kanë për detyrë të trajtojnë aplikimet e lejeve për ndërtim. Sipas AKSHI-t, sistemi ishte përdorur 25,000 herë nga qytetarët dhe bizneset dhe se kishte 1,155 përdorues nga institucionet shtetërore (nëpunës civilë) gjatë periudhës shtator-dhjetor 2016.³

A mundësoi qeverisje të hapur?

Aksesi tek informacioni: Nuk ndryshoi
Pjesëmarrja qytetare: Nuk ndryshoi
Llogaridhënia publike: Nuk ndryshoi

Edhe pse ky angazhim ka efekt pozitiv në thjeshtimin e procedurave për aplikimin për leje ndërtimi nga ana e bizneseve, ai nuk solli si rezultat ndonjë ndryshim që të lidhej me vlerat PQH të aksesit tek informacioni, pjesëmarrjes qytetare apo llogaridhënies publike.

Hapat e mëtejshëm

Ky angazhim është zbatuar plotësisht dhe hulumtuesi MRP rekomandon që ai të mos vazhdohet në planin e ardhshëm të veprimit, sepse ai nuk ka lidhje me vlerat PQH dhe qeverinë e hapur.

¹ Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit, “AKSHI dhe AKPT projekti i përfunduar”, 19 tetor 2016, <http://www.azht.gov.al/all/newsroom/lajme/lejet-e-ndertimit-online-sherbimi-e-leje>

² Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit, Manual për e-leje, http://www.azht.gov.al/files/news_files/17-02-28-03-25-26Manual_Aplikimi_ne_e-leje.pdf, manual për nënshkrimin elektronik, http://www.azht.gov.al/files/news_files/17-02-28-03-25-28Manual_Teknik_Nenshkrimi_Elektronik.pdf, dhe adresë për video, <https://www.youtube.com/watch?v=dydIDbXqrTw>

³ Strategjia ndërsektoriale për reformën në administratën publike 2015-2020, raporti vjetor i monitorimit 2016, mars 2017, faqe 41, <http://dap.gov.al/images/DokumentaStrategjik/SNRAP%20Raporti%20Vjetor%202016%20Final%2016.03.2017.pdf>

12. Ngritja e sporteleve dixhitale

Teksti i angazhimit:

Titulli: Instalimi dhe shpërndarja e sporteleve dixhitale

Me qëllim përmirësimin e shërbimeve publike që u ofrohen qytetarëve dhe promovimin e teknologjive më të fundit, AKSHI ka marrë iniciativën për të instaluar sportele (sportele) dixhitale në të gjithë vendin.

Prezantimi për herë të parë i sporteleve dixhitale do të mundësojë rritjen e transparencës në ofrimin e shërbimeve nga administrata. Përmes formës elektronike, AKSHI synon të përmirësojë disponueshmërinë, cilësinë dhe transparencën e shërbimeve publike dhe të zvogëlojë kohën e zbatimit të procedurave dhe shpenzimet e administratës publike.

Përmes shpërndarjes së sporteleve dixhitale, portali e-Albania synon të sigurojë akses dhe lundrim më të lehtë në internet për të gjithë qytetarët shqiptarë, të cilët mund t'i drejtohen në një pike të vetme të aksesit publike tek informacionet ose shërbime publike online që ofrohen përmes portalit unik të e-qeverisjes. Sportele dixhitale do të ofrojnë shërbime publike 24 orë në ditë në 7 ditë të javës.

Institucioni përgjegjës: Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI)

Institucion(et) mbështetës(e): bashkëpunim i ngushtë me sektorin privat

Data e fillimit: 2016

Data e mbarimit: 2017

Përmbledhje e angazhimit	Detajimi				Lidhja me vlerën PQH (siç shkruhet)			Ndikimi i mundshëm		Zbatimi		Afat-mesëm Përfundimtar		A mundësoi qeverisje të hapur?							
	Nuk ka	I ulët	Mesatar	I lartë	Akresi në Informacion	Pjesëmarrja qytetare	Llogaridhënia publike	Tek. e Inov. për transp. e llogaridhën.	Nuk ka	I vogël	Mesatar	Transformues	Nuk ka filluar ende	I kufizuar	I konsiderueshëm	I përfunduar	E përkeqësoi	Nuk e ndryshoi	Paksa	Konsiderueshëm	Jashtëzakonisht shumë
12. Ngritja e sporteleve dixhitale	✓				I paqartë			✓							✓		✓				

Synimi i angazhimit

Ky angazhim kishte si synim ngritjen e sporteleve (apo kioskave) digjitale në mjediset publike në të gjithë vendin për të siguruar akses më të lehtë në internet për të gjithë qytetarët. Duke vizituar këto sportele dixhitale, qytetarët do të jenë në gjendje të kenë akses tek portali e-Albania, portali i e-qeverisjes, 24/7. Përmes ofrimit të shërbimit në mënyrë elektronike, AKSHI synon të përmirësojë disponueshmërinë e shërbimeve publike dhe të ulë kohën e zbatimit të procedurave dhe shpenzimet e administratës publike. Me t'u futur në sistem, qytetarët do të jenë në gjendje të bëjnë pagesa, të marrin informacion në lidhje me shërbimet publike, certifikata të shtypura, etj.

Zbatimi

Periudha afatmesme: I përfunduar

Instalimi i sporteve digjitale për t'u bërë të mundur qytetarëve akses te shërbimet e-Albania u njoftua në dhjetor 2015. Raporti vjetor i AKSHI-t i vitit 2016 dhe portali e-Albania njoftoi se 15 sportele dixhitale ishin instaluar në 10 bashki. Ky proces u shoqërua me disa aktivitete informimi për mënyrën e përdorimit të sporteve dixhitale dhe përparësitë e tjera të ofruara përmes tyre.¹

A mundësoi qeverisje të hapur?

Akresi tek informacioni: Nuk ndryshoi

Pjesëmarrja qytetare: Nuk ndryshoi


Llogaridhënia publike: Nuk ndryshoi

Ky angazhim nuk ka lidhje me PQH për nga mënyra si është formuluar dhe zbatimi i tij nuk rezultoi në ndonjë ndryshim që të kishte lidhje me vlerat PQH të aksesit tek informacioni, pjesëmarrjes qytetare dhe llogaridhënies publike.

Hapat e mëtejshëm

Në kohën kur po përgatitej ky raport, plani i ri i veprimit nuk ishte publikuar ende në Shqipëri. Hulumtuesi MRP rekomandon që ky angazhim të mos vazhdojë në planin tjetër të veprimit, sepse ai nuk ka një lidhje të qartë me vlerat PQH.

¹ Raporti i Progresit të Shqipërisë nga MRP 2016-2017.



Synimi i angazhimit

Ky angazhim u bazua në reformën e shërbimeve publike dhe kishte si synim të vazhdonte standardizimin e 700 pasaportave të shërbimit (kartelave informuese) për të ofruar informacion të thjeshtë e të unifikuar për të gjitha shërbimet sipas institucioneve. Secili shërbim do të ketë pasaportën e vet, i cili përfshin informacione të tilla si emri i institucionit, emri i shërbimit, përshkrimin, dokumentacionin që kërkohet, dokumentin që lëshohet, vlefshmëria e dokumentit, përfituesit e shërbimit, koha e marrjes së tij, tarifa, dhe sistemi i ankesave. Përgjegjëse për përgatitjen dhe standardizimin e pasaportave të shërbimit është Agjencia për Ofrimin e Shërbimeve të Integruara (ADISA).

Zbatimi

Periudha afatmesme: I konsiderueshëm

Në fund të vitit 2016, numri i institucioneve që standardizuan pasaportat e shërbimit arriti në 18 (nga 10 institucione në fillim të periudhës së zbatimit në korrik 2016). Deri në fund të vitit 2016 u standardizuan gjithsej 481 pasaporta shërbimi¹. ADISA i raportoi Hulumtuesit MRP se janë realizuar gjithsej 548 pasaporta shërbimi nga 20 institucione shtetërore. 475 prej tyre (nga 13 institucione) tashmë janë standardizuar deri në fund të periudhës së raportimit. ADISA po punonte për të standardizuar edhe 42 pasaporta shërbimesh, të cilat janë zhvilluar për shtatë institucione shtetërore.²

Periudha përfundimtare: I përfunduar

Gjatë 2018, ADISA e kishte përmbytur plotësisht objektivin e saj të standardizimit të 700 pasaportave të shërbimeve, për 35 institucione publike, gjë që pothuajse është dyfishi i numrit të institucioneve (20) të raportuara në vitin 2017.³ Po ashtu, ADISA ka krijuar në aplikacion për telefonat celularë për akses më të lehtë të shërbimeve publike nga qytetarët në portalin e-Albania.⁴

A mundësoi qeverisje të hapur?

Aksesi tek informacioni: I vogël

Edhe pse informacioni që përfshihet në pasaportat e shërbimit është i kufizuar dhe duhet të jetë pjesë përbërëse e shërbimeve elektronike, ADISA mendon se ato rrisin aksesin tek informacioni dhe transparencën në lidhje me shërbimet që ofrohen (p.sh., dokumentet e nevojshme, tarifat, etj.). Për mënyrën si u zbatua, angazhimi ndihmoi në lehtësimin e përdorimit të shërbimeve elektronike duke ofruar informacion të standardizuar për shërbimet elektronike (udhëzime bazë për mënyrën e përdorimit të disa shërbimeve) nëpërmjet portalit e-Albania, sporteleve digjitale dhe aplikacionit ADISA Mobile. Megjithatë, duke qenë se ky informacion nuk është i ri dhe mund të gjendej edhe nëpërmjet kanaleve të tjera para këtij angazhimi, kontributi i pasaportave të shërbimeve në rritjen e aksesit të publikut tek informacioni për shërbimet që ofrohen nga qeveria dhe për cilësinë e tyre ishte i vogël.

Hapat e mëtejshëm

Në kohën kur po përgatitej ky raport, plani i ri i veprimit nuk ishte publikuar ende në Shqipëri. Hulumtuesi MRP rekomandon që ky angazhim, nëse përfshihet në planin tjetër të veprimit, të orientohet më qartë drejt përmirësimit të aksesit tek informacioni publik.

¹ Strategjia ndërsektorale për reformën në administratën publike 2015-2020, raporti vjetor i monitorimit për “Strategjia ndërsektorale për reformën në administratën publike 2015-2020”, faqe 35-36,
<http://dap.gov.al/images/DokumentaStrategjik/SNRAP%20Raporti%20Vjetor%202016%20Final%2016.03.2017.pdf>

² Anisa Gjika, Drejtore e ADISA, intervistë nga Hulumtuesi MRP, tetor 2017.

³ Pasaporta e shërbimit është një dokument i shkurtër me informacione bazë për një shërbim publik, p.sh.,
http://www.adisa.gov.al/wp-content/uploads/2019/02/AL022015_AKDC.pdf. Të gjitha pasaportat e shërbimeve mund të konsultohen në adresën <http://www.adisa.gov.al/kartela-informative/>

⁴ Aplikacioni ADISA mobile, Play store, <https://play.google.com/store/apps/details?id=com.kleo.xhindoli>; dhe App store, <https://itunes.apple.com/us/app/adisa-mobile-app/id1313723696?mt=8>

14. Kartela informative e qytetarit

Teksti i angazhimit:

Ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike, në bashkëpunim me Agjencinë e Ofrimit të Shërbimeve të Integruara (ADISA) ndërmori nismën për krijimin e një dokumenti publik, i cili, për herë të parë, do të ofrohet për t'u garantuar qytetarëve dhe institucioneve informacione për standardet bazë për ofrimin e shërbimeve publike në sportele. Institucionet dhe qytetarët nuk dinin gjë për këtë lloj informacioni më parë.

Ky angazhim duhet të përmbushet nga ADISA, si autoriteti përgjegjës për standardizimin e metodave të ofrimit të shërbimeve publike në sportele, duke krijuar Kartelën informative të Qytetarit, ku do të përfshihen për secilin shërbim/informacion mënyrat/kanalet për marrjen e shërbimit:

- Rregullat e sjelljes në sportelet fizike;
- Rregullat për aplikimin në sportelet fizike të shërbimit;
- Rregullat për marrjen e përgjigjeve nga sportelet fizike;
- Rregullat për ankesë;
- Modele të përfaqësimit vizual në sportelet fizike;
- Elementet e nevojshme të shërbimit në sportelet fizike;
- Rregullat e komunikimit dhe të organizimit të informacionit për shërbimet;
- Rregullat për përdorimin e formave dhe funksionalitetit të kanaleve të ndryshme për ofrimin e shërbimeve publike nga këndvështrimi i personave fizikë dhe juridikë;
- Klasifikimi i shërbimeve;
- Kodifikimi i shërbimeve;
- Formularët për aplikimin e shërbimit

Hartimi dhe publikimi i kartelës informative përgjithësisht në print apo në format elektronik do të siguronte rritjen e transparencës, shpejtësinë e shërbimit, ofrimin e shërbimit, përmirësimet e vazhdueshme, performancës dhe do të ofronte mjete alternative për luftën kundër korrupsionit.

Institucioni përgjegjës: Agjencia e Ofrimit të Shërbimeve të Integruara Albania

Institucion(et) mbështetës(e): Ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike dhe të gjitha ministrinë e linjës

Data e fillimit: 2017

Data e mbarimit: 2018

Shënim redaksional: Për të lexuar të gjithë tekstin e angazhimit, lutemi referojuni https://www.opengovpartnership.org/sites/default/files/Albania_NAP3_ENG.pdf.

Përmbledhje e angazhimit	Detajimi	Lidhja me vlerën PQH (siç shkruhet)	Ndikimi i mundshëm	Zbatimi	Afat-mesëm Për-fundimtar	A mundësoi qeverisje të hapur?
--------------------------	----------	-------------------------------------	--------------------	---------	--------------------------	--------------------------------

	Nuk ka	I ulët	Mesatar	I lartë	Akresi në Informacion	Pjesëmarrja qytetare	Llogaridhënia publike	Tek. e Inov. për transp. e llogaridhën.	Nuk ka	I vogël	Mesatar	Transformues	Nuk ka filluar ende	I kufizuar	I konsiderueshëm	I përfunduar	E përkeqësoi	Nuk e ndryshoi	Paksa	Konsiderueshëm	Jashtëzakonisht shumë
14. Kartela informative e qytetarit			✓	✓					✓						✓			✓			

Synimi i angazhimit

Ky angazhim kishte si synim të krijonte një kartelë informative për qytetarët për të siguruar transparencë në lidhje me standardet për ofrimin e shërbimeve publike dhe rritjen e performancës së këtyre shërbimeve si dhe ofrimin e mjeteve alternative për të luftuar korrupsionin. Sipas Agjencisë për Ofrimin e Shërbimeve të Integruara (ADISA), kartela e qytetarëve përbën një detyrim ligjor për ofrimin e shërbimeve elektronike cilësore si dhe parakusht dhe “infrastrukturë” e nevojshme në bazë të së cilës ADISA mund të masë efikasitetin dhe cilësinë e shërbimeve publike që ofrohen elektronikisht. Po ashtu, angazhimi parashikon me detaje se çfarë informacioni duhet të përfshijë kartela e qytetarëve për të orientuar përdoruesit nëpërmjet shërbimeve elektronike, si agjencia, pika e aksesit, si të përdoret shërbimi etj.

Zbatimi

Periudha afatmesme: I konsiderueshëm

ADISA ka raportuar se zhvillimi i kartelës së qytetarëve ka filluar para këtij angazhimi në vitin 2015 dhe ka vazhduar deri në vitin 2016. Gjatë periudhës së zbatimit të këtij angazhimi ADISA ka zhvilluar elementët e mëposhtëm të kartelës informative të qytetarëve: informacionet për korrupsionin dhe transparencën, shpejtësinë e shërbimit, ekzekutimin e shërbimit, përmirësimin dhe performancën.¹

Në dhjetor të vitit 2016, drafti i kartelës së qytetarëve iu dërgua 18 institucioneve, siç iu raportua hulumtuesit MRP nga ADISA. Në maj të vitit 2017, ADISA dhe Ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike (MIAP) kryen një konsultim me shkollat e mesme dhe më pas krijuan një model duke identifikuar se cilat informacione duhet të përfshihen në kartelën informative të qytetarëve. Në qershor të vitit 2017 u kryen konsultime shtesë me institucionet përgjegjëse me qëllim që të gjehej gjuha e përbashkët për masat që duhet të ndërmarrin për të përmbushur detyrimin për kartelën informative të qytetarëve.²

Periudha përfundimtare: I përfunduar

Gjatë 2018 qeveria vazhdoi konsultimet për kartelën informative të qytetarëve me institucionet shtetërore³ dhe me publikun.⁴ Në portalin e qeverisë u publikua një draft i kartelës informative, por nga publiku nuk u dhanë mendime e sugjerime.⁵ Kartela e qytetarit u miratua nga Këshilli i Ministrave me VKM Nr. 623, datë 26.10.2018.⁶

A mundësoi qeverisje të hapur?

Akresi tek informacioni: I vogël

Informacioni që ofrohet në kartelat e qytetarëve është informacion që orienton përdoruesit tek e-shërbimet, si agjencia e duhur, pikat e aksesit, dhe mënyra e përdorimit të shërbimit, etj.⁷ E miratuar

në tetor 2018, kartela është e dobishme për të bërë të mundur që të kuptohet më mirë dhe të aksesohen më mirë shërbimet elektronike, përfshirë të drejtat dhe detyrimet e qytetarëve (edhe pse ky informacion mund të aksesohet në mënyra të tjera, si telefon, faqe zyrtare të institucioneve, faqja zyrtare e Komisionerit për të drejtën e informimit, Avokati i Popullit, etj.). Prandaj, kontributi i këtij angazhimi tek aksesimi në informacion ishte i vogël.

Hapat e mëtejshëm

Në kohën kur po përgatitej ky raport, plani i ri i veprimit nuk ishte publikuar ende në Shqipëri. Rekomandohet që të hartohet përmbajtja dhe të zgjerohet përdorimi i kartelave të qytetarëve nëpërmjet agjendës PQH për sa kohë kjo kartelë ofron informacione të reja të dobishme për qytetarët.

¹ Anisa Gjika, Drejtore e ADISA, intervistë nga Hulumtuesi MRP, tetor 2017.

² Informacion i dërguar nga ADISA, komunikimi me email me Hulumtuesin MRP, tetor 2017.

³ Zyrtar i ADISA, intervistë nga Hulumtuesi MRP, qershor 2018.

⁴ Zv. Kryeministër Senida Mesi duke ftuar grupe të rinjsh për konsultime publike, <https://www.facebook.com/senidamesi.al/photos/a.1831004317221721/2138893386432811/?type=3&theater>

⁵ Portali i konsultimit publik, <https://konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Detaje/88>

⁶ Këshilli i Ministrave nëpërmjet VKM Nr. 623 datë 26 tetor 2018 publikuar në Fletoren Zyrtare nr. 155 datë 2 nëntor 2018, http://www.qbz.gov.al/Botime/fletore_zyrtare/2018/PDF-2018/155-2018.pdf

⁷ Shpjegim për kartën e qytetarit në revistën e ADISA-s, faqe 44, http://www.adisa.gov.al/wp-content/uploads/2018/07/Revista_ADISA.pdf

15. Receta elektronike pilot

Teksti i angazhimit:

Titulli: Sistemi elektronik i regjistrimit të e-recetës në Republikën e Shqipërisë

Ky angazhim ka për qëllim të zëvendësojë recetën mjekësore letër me recetën elektronike në të gjithë vendin. Përbushja e këtij angazhimi sjell rritjen e efikasitetit të fondeve mjekësore të rimbursimit të barnave dhe saktësinë e përcaktimit të barnave mjekësore duke ndikuar kështu drejtpërdrejt në përmirësimin e cilësisë së shëndetit të pacientëve dhe të kujdesit shëndetësor.

Ndër të tjera, receta elektronike do të sjellë:

- Uljen e mundësive për gabim që vjen si rezultat i keqkuptimit të shkrimit mes mjekëve dhe farmacistëve
- Reduktimin e kohës administrative për komunikimin mes pacientit-mjekut, pacient-farmacistë, farmacistë-Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor
- Rritjen e nivelit të përputhjes së barnave që i jepen pacientit dhe rritja e rehatisë të pacientit edhe në marrjen e këtyre barnave
- Sistemi do të bëjë të mundur mbledhjen e të dhënave historike të mjekimeve që ka marrë pacienti.

Institucioni përgjegjës: Ministria e Shëndetësisë

Institucion(et) mbështetës(e): Farmacitë

Data e fillimit: 2016

Data e mbarimit: 2017

Shënim redaksional: Për të lexuar të gjithë tekstin e angazhimit, lutemi referojuni

https://www.opengovpartnership.org/sites/default/files/Albania_NAP3_ENG.pdf.

Përmbledhje e angazhimit	Detajimi				Lidhja me vlerën PQH (siç shkruhet)				Ndikimi i mundshëm				Zbatimi		Afat-mesëm Përfundimtar		A mundësoi qeverisje të hapur?				
	Nuk ka	I ulët	Mesatar	I lartë	Akresi në Informacion	Pjesëmarrja qytetare	Llogaridhënia publike	Tek. e Inov. për transp. e llogaridhën.	Nuk ka	I vogël	Mesatar	Transformues	Nuk ka filluar ende	I kufizuar	I konsiderueshëm	I përfunduar	E përkeqësoi	Nuk e ndryshoi	Paksa	Konsiderueshëm	Jashtëzakonisht shumë
15. Receta elektronike pilot	✓				I paqartë				✓				✓				✓				

Synimi i angazhimit

Objekti i këtij angazhimi është zëvendësimi i recetave mjekësore prej letre me receta elektronike në të gjithë vendin. Deri para këtij angazhimi, recetat mjekësore regjistroheshin vetëm në letër dhe ishte e vështirë të menaxhohej vëllimi i përpunimit të recetave prej letre. Ministria e Shëndetësisë,

pasi kishte pilotuar me sukses sistemin elektronik të recetave në rrethin e Durrësit, u angazhua në zgjerimin e këtij sistemi në të gjithë Shqipërinë. Rezultati i synuar i këtij sistemi, siç përshkruhej në planin e veprimit, është i shumëfishtë. Qeveria kishte si synim sistemin e recetave elektronike për të sjellë këto ndryshime: krijimin e një regjistri me historikun e mjekimit të pacientëve; rritjen e efektivitetit të përdorimit të fondeve të rimbursimit të barnave; rritjen e saktësisë së përcaktimit të ndikimit të barnave mjekësore në shëndetin e pacientit dhe kujdesin shëndetësor; uljen e numrit të receta të rreme; uljen e numrit të gabimeve mes mjekëve dhe farmacistëve; rritjen e nivelit e përputhshmërisë së barnave që u jepen pacientëve.

Zbatimi

Periudha afatmesme: I kufizuar

Sistemi i recetave elektronike u nis në Tiranë në mars 2017.¹ Më herët, më janar 2017, u trajnuan për përdorimin e recetave elektronike 317 punonjës të kujdesit shëndetësor. Ky aplikacion shërbehet nëpërmjet portalit e-Albania;² shpjegohet nëpërmjet një numri materialesh ndihmëse (video) dhe është e ndërlidhur me kartat e shëndetit të qytetarëve

Hulumtuesi MRP pati mundësinë të përcaktonte përdorimin e sistemit të recetës elektronike në Durrës dhe Tiranë. Institucionet përgjegjëse nuk ofruan informacione për rezultatet. Nga ana tjetër, nuk pati as informacione për ndonjë plan për shtrirjen e sistemit në të gjithë vendin.³

Periudha përfundimtare: I kufizuar

Ky angazhim bëri progres gjatë periudhës tetor 2017-teetor 2018. Sistemi është operacional dhe funksional⁴ dhe sipas përfaqësuesit të Fondit të Sigurimeve Shëndetësore, ky sistem po përdoret aktualisht nga rreth 1,500 mjekë në institucionet e shëndetit publik.⁵

Megjithatë, sistemi i recetave elektronike nuk është zbatuar plotësisht në të gjithë vendin. Vetëm 9 nga 12 qarqet e kanë sistemin në punë sipas zyrtarëve të Ministrisë së Shëndetësisë (tetor 2018) – Tirana, Durrësi, Fieri, Shkodra, Elbasani, Korça, Vlora, Berati dhe Dibra. Për më tepër, Hulumtuesi MRP evidentoi se sistemi i recetave elektronike nuk përdoret nga të gjitha institucionet shëndetësore në të gjitha bashkitë e këtyre 9 qarqeve. Duke e pranuar këtë fakt, Ministria e Shëndetësisë po fokusohet tek institucionet rajonale shëndetësore me objektivin kryesor për të mbuluar të gjitha qarqet deri në fund të vitit 2018. Sipas Ministrisë, të gjitha recetat për ilaçet e rimbursueshme jepen nëpërmjet sistemit e-prescription. Konkretisht, kjo përfshin 413 qendrat shëndetësore, 1600 mjekë të shërbimit bazë dhe 13 spitale.⁶

Një raport investigativ i publikuar nga media që bazohet në informacione që vinin nga Kontrolli i Lartë i Shtetit konstatonte se sistemi i recetave elektronike nuk funksiononte mirë për shkak të lidhjes së dobët me internetin.⁷ Alfred Leskaj (Inspektor i KLSH-së) raportoi se institucionet e kujdesit shëndetësor në rreth 69% të mbulimit aktual me sistemin e recetës elektronike vazhdojnë ende të lëshojnë receta me shkrim dhe nuk janë në gjendje të përdorin sistemin për shkak të lidhjes së dobët me internetin.

A mundësoi qeverisje të hapur?

Aksesi tek informacioni: Nuk ndryshoi

Pjesëmarrja qytetare: Nuk ndryshoi

Llogaridhënia publike: Nuk ndryshoi

Ky angazhim nuk kontribuoi në ndonjë ndryshim për sa i përket punës së qeverisë në lidhje me aksesin e qytetarëve tek informacioni, pjesëmarrjen e publikut apo llogaridhënien publike, pavarësisht përmirësimeve të pritshme që kanë të bëjnë me cilësinë e shërbimit për qytetarët.

Hapat e mëtejshëm

Në kohën kur po përgatitej ky raport, Shqipëria nuk e kishte publikuar ende planin e ri të veprimit. Nëse angazhimi për recetat mjekësore përfshihet në planin tjetër të veprimit, ai duhet të fokusohet qartë në ecurinë e mëtejshme të vlerave PQH.

¹ Ministria e Shëndetësisë, lidhja me sistemin e recetave elektronike, <http://www.shendetesia.gov.al/al/newsroom/lajme/receta-elektronike-beqaj-vijon-normalisht-zbatimi-ne-4-ditet-e-para-te-tirane>

² lidhja me sistemin e recetave elektronike, http://apps.fsdksh.com.al:7777/PublicIdm;PublicIdmApp=cs4cY_ICDeXHVPF3IM0WScNP5eYqULi2ENcfxnHaw6kRltz0Nta!1784821236

³ Raporti i Progresit të Shqipërisë nga MRP 2016/17, https://www.opengovpartnership.org/sites/default/files/Albania_Mid-Term_2016-2018_EN_for-pub-comm.pdf

⁴ lidhja me aplikimin e recetave elektronike, http://apps.fsdksh.com.al:7777/PublicIdm;PublicIdmApp=os_gOeZL5BzKJRh9F5NP8oDS0Q8A9T-MI_vmE925G0M_JHyTzWFM!-70656013

⁵ Zyrta i Fondit të Sigurimeve Shëndetësore, intervistë nga Hulumtuesi MRP, shtator 2018.

⁶ MRP e mori këtë informacion nga Ministria e shëndetësisë dhe mbrojtjes sociale gjatë periudhës së para-publikimit të këtij raporti (3 korrik 2019).

⁷ Top Channel TV, “Receta elektronike s’funksionon, KLSH konstaton një sërë problemesh”, korrik 2018, <http://top-channel.tv/2018/07/31/receta-elektronike-sfunksionon-klsh-konstaton-nje-sere-problemesh/>

16. Sistemi i monitorimit elektronik të pyjeve

Teksti i angazhimit:

Ky angazhim synon të krijojë një sistem të integruar që do të mundësojë monitorimin e aktiviteteve të paligjshme dhe identifikimin në kohë të zjarreve si një nga objektivat strategjikë të programit të qeverisë në lidhje me pyjet.

Ky angazhim synon:

- Krijimin e një sistemi të integruar për monitorimin e pyjeve për të parandaluar prerjen e paligjshme të pyjeve;
- Zbulimet në kohë reale të zjarreve që mund të ndodhin në zonat që do të mbulohen nga sistemi;
- Monitorimin gjatë 24/365, përcaktimin e pikave kyçe për të parandaluar dhe kontrolluar transportin e materialit të prerjes së paligjshme të drurit nga pyjet drejt qendrave urbane ku mblidhet dhe tregtohet.
- Përmirësimin e cilësisë së shërbimit për parandalimin e shkeljeve të prerjes së pyjeve.
- Shkëmbimin e informacionit në kohë reale me strukturat e tjera përgjegjëse për monitorimin dhe ndjekjen penale të autorëve të veprave të paligjshme
- Uljen e korrupsionit në këtë fushë.

Institucioni përgjegjës: Ministria e Mjedisit

Institucion(et) mbështetës(e): Inspektorati Shtetëror i Mjedisit dhe Pyjeve

Data e fillimit: Gusht 2016

Data e mbarimit: 2017

Shënim redaksional: Për të lexuar të gjithë tekstin e angazhimit, lutemi referojuni https://www.opengovpartnership.org/sites/default/files/Albania_NAP3_ENG.pdf

Përmbledhje e angazhimit	Detajimi				Lidhja me vlerën PQH (siç shkruhet)				Ndikimi i mundshëm				Zbatimi				Afat-mesëm Përfundimtar				A mundësoi qeverisje të hapur?			
	Nuk ka	I ulët	Mesatar	I lartë	Akresi në Informacion	Pjesëmarrja qytetare	Llogaridhënia publike	Tek. e Inov. për transp. e llogaridhën.	Nuk ka	I vogël	Mesatar	Transformues	Nuk ka filluar ende	I kufizuar	I konsiderueshëm	I përfunduar	E përkeqësoi	Nuk e ndryshoi	Paksa	Konsiderueshëm	Jashtëzakonisht shumë			
16. Sistemi i monitorimit elektronik të pyjeve			✓		I paqartë				✓				✓				✓							

Synimi i angazhimit

Ky angazhim kishte si synim të krijonte një sistem monitorimi elektronik të pyjeve. Sistemi do të përfshijë zbulimin në kohë reale të zjarreve, kamera monitoruese, shkëmbim informacioni në kohë reale me strukturat e monitorimit dhe të tjera. Ngritja e këtij sistemi do të ulë edhe kostot e inspektimeve, siç përshkruhet në planin e veprimit. Gjuha e angazhimit përcakton numrin e kamerave që do të instalohen, pikat kryesore të instalimit dhe transmetimin e pamjeve tek Policia Pyjore dhe strukturat e tjera kompetente.

Zbatimi

Periudha afatmesme: Nuk ka filluar ende

Hulumtuesit MRP nuk iu ofrua informacion për zbatimin e këtij angazhimi. Nga monitorimi i faqeve të internetit dhe i raporteve për punën e institucioneve përgjegjëse (Ministria e Mjedisit dhe Inspektorati Shtetëror i Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave) nuk u identifikua ndonjë aktivitet lidhur me këtë angazhim, përveç pilotimit të një sistemi të ngjashëm në qarqet e Shkodrës dhe Tiranës. Në periudhën afatmesme, ish Ministria e Mjedisit ishte integruar në Ministrinë e Turizmit dhe nuk kishte informacione për sa i përket pikave të kontaktit për këtë angazhim.

Periudha përfundimtare: i përfunduar

Ministria e financave e ka përfshirë sistemin elektronik të monitorimit të pyjeve në planin e vet të investimeve për periudhën 2018 – 2020.¹ Sipas Ministrisë së turizmit dhe mjedisit, aktualisht janë 28 pika vrojtimi në qarqet Dibër, Elbasan, Korçë, Vlorë, Shkodër, Lezhë, Tiranë dhe Durrës. Zyrat e monitorimit pranë Inspektoriatit shtetëror të mjedisit, pyjeve, ujrave dhe turizmi (ISHMPUT) janë operacionale 24/7 dhe raportojnë raste të prerjes së paligjshme të pyjeve tek autoritetet policore. Kamerat janë të vendosura në pika kyçe me risk të lartë për transportin ilegal nga pyjet drejt qendrave urbane dhe ato mund të sinjalojnë për zjarre në pyje në kohë reale.

A mundësoi qeverisje të hapur?

Akresi tek informacioni: Nuk ndryshoi

Pjesëmarrja qytetare: Nuk ndryshoi

Llogaridhënia publike: Nuk ndryshoi

Ky angazhim përbën një masë pozitive por të vogël për trajtimin e shqetësimeve që lidhen me menaxhimin efikas të burimeve publike dhe monitorimin e veprimtarisë së firmave private që punojnë me burimet natyrore (pyjet). Megjithatë, lidhja e këtij angazhimi me vlerat PQH, siç u përshkrua edhe më sipër, mbetet e paqartë.

Hapat e mëtejshëm

Në kohën kur po përgatitej ky raport, Shqipëria nuk e kishte publikuar ende planin e ri të veprimit dhe nuk është e qartë nëse ky angazhim do të vazhdojë edhe në planin tjetër. Qeveria mund të ndër marrë një angazhim në këtë fushë duke prezantuar masa që lidhen me publikimin e të dhënave për menaxhimin e pyjeve (p.sh., publikimi i rezultateve të sistemit të monitorimit online); përfshirja e shoqërisë civile dhe promovimi i pjesëmarrjes qytetare gjatë hartimit, zbatimit, monitorimit dhe vlerësimit të sistemit (p.sh., duke iu kërkuar qytetarëve të kontribuojnë në sistem me të dhëna nga situata aktuale e pyjeve, zjarret e zbuluara, prerja e paligjshme e pemëve, etj.); përmirësimi i llogaridhënies publike duke ngritur një sistem raportimi publik online së bashku me sanksionet përkatëse. Angazhimet e ardhshme në këtë fushë mund të hartohen në konsultim të vazhdueshëm me Analizën e Tretë të Performancës Mjedisore të Shqipërisë, siç sugjerohet nga Komisioni Ekonomik i Kombeve të Bashkuara për Evropën.²

¹ Plani 2018-2020 i Ministrisë së financave, https://financa.gov.al/wp-content/uploads/2017/11/Lista_e_Investimet_Publike_2018-2020.xlsx

² Analiza e Tretë të Performancës Mjedisore të Shqipërisë, UNECE, shtator 2018,
https://www.unece.org/fileadmin/DAM/env/epr/epr_studies/ECE.CEP.183_Eng.pdf

17. Sistemi elektronik për aplikimet për licenca profesionale

Teksti i angazhimit:

Titulli: Sistemi elektronik i integruar për licencimin profesional të individëve dhe personave juridikë që do të vepronë në fushën e studimit e projektimit dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të ndërtimit

Ministria e Zhvillimit Urban është përgjegjës për hartimin dhe zbatimin e legjislacionit, strategjive dhe politikave (ndër të tjera) në fushën e licencimit profesional të individëve dhe personave juridikë që vepronë në fushën e studimit e projektimit dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të ndërtimit.

Aktualisht, Ministria e Zhvillimit Urban nuk ka një aplikacion të informatizuar për të menaxhuar aplikimet për licencime profesionale në fushat e mësipërme dhe çdo praktikë në këtë kohë bëhet vetëm me letër. Ky projekt do të ofrojë aplikacione online për licencimin profesional përmes një interoperabiliteti të unifikuar të portalit qeveritar dhe ofrimit të tyre në e-albania.al, duke vepruar kështu në përputhje me nismat e Qeverisë Shqiptare për ofrimin e shërbimeve elektronike për qytetarët dhe bizneset.

Objektivi kryesor i këtij angazhimi është përmirësimi i shërbimeve të ofruara për përfituesit në lidhje me licencimin profesional të individëve dhe personave juridikë që vepronë në fushën e studimit e projektimit dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të ndërtimit. Në këtë mënyrë, qytetarët, bizneset dhe grupet e interesit do të mund t'i referohen informacioneve thelbësore dhe të vërtetuara në aspektin e individëve dhe personave juridikë që vepronë në fushën e studimit e projektimit dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të ndërtimit.

Sistemi do të përmirësojë ofrimin e shërbimeve ndaj qytetarëve, do të lehtësojë procedurat, do të përshpejtojë dhe rrisë më tej transparencën e sistemit brenda ministrisë, mes ministrive dhe institucioneve të tjera publike si dhe me publikun. Ai do të shfrytëzojë të gjithë bazën e të dhënave dhe informacionet dhe do të minimizojë sa më shumë ndërhyrje njerëzore në proces, gjatë kryerjes së kontrollit aritmetik dhe logjik.

Institucioni përgjegjës: Ministria e Zhvillimit Urban

Institucion(et) mbështetës(e): Ministria e Zhvillimit Urban

Data e fillimit: 2016

Data e mbarimit: 2017

	Detajimi				Lidhja me vlerën PQH (siç shkruhet)				Ndikimi i mundshëm				Zbatimi		Afat-mesëm		A mundësoi qeverisje të hapur?				
	Nuk ka	I ulët	Mesatar	I lartë	Akresi në Informacion	Pjesëmarrja qytetare	Llogaridhënia publike	Tek. e Inov. për transp. e llogaridhën.	Nuk ka	I vogël	Mesatar	Transformues	Nuk ka filluar ende	I kufizuar	I konsiderueshëm	I përfunduar	E përkeqësoi	Nuk e ndryshoi	Paksa	Konsiderueshëm	Jashtëzakonisht shumë
Përmbledhje e angazhimit																					
17. Sistemi elektronik për aplikimet për licenca profesionale			✓		I paqartë					✓					✓		✓				

Synimi i angazhimit

Para miratimit të këtij angazhim, Ministria e Zhvillimit Urban nuk kishte asnjë program softuer për të menaxhuar aplikimet për licenca profesionale të individëve dhe subjekteve juridike që operojnë në fushën e projekteve urbane dhe mbikëqyrjes dhe kolaudimit të punëve në ndërtim; dosjet e aplikimeve përpunoheshin me dorë dhe në letër. Objektivi kryesor i këtij angazhimi ishte përmirësimi i transparencës në lidhje me ofruesit e mundshëm të shërbimeve që lidhen me ndërtimin, një masë e rëndësishme për të përmirësuar cilësinë e punëve të ndërtimit dhe të sigurisë së ndërtimeve. Ky angazhim përshkruante tre aktivitete: ngritjen e një shërbimi online për aplikimet për licencë profesionale përmes portalit e-Albania; ofrimin e informacionit në kohë reale për të verifikuar statusin e aplikimit; dhe përmirësimin e kapaciteteve të monitorimit të Ministrisë.

Zbatimi

Periudha afatmesme: I konsiderueshëm

Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 943 (datë 28 dhjetor 2016) përcakton rregullat për përmirësimin e shërbimeve të ofruara për përfituesit në lidhje me licencimin profesional të individëve dhe personave juridikë që veprojnë në fushën e studimit e projektimit dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të ndërtimit.¹ Kështu, u bë e mundur që aplikimi për licencë individuale të bëhej në portalin e-Albania² dhe deri në qershor 2017, të gjitha aplikimet dorëzohen online.³ Megjithatë, Hulumtuesit MRP nuk iu dha ndonjë informacion lidhur me shkëmbimin e informacionit në kohë reale për të verifikuar statusin e aplikimit ose për përmirësimin e kapacitetit për monitorim. Kështu, zbatimi i këtij angazhim mund të kodohet si “i konsiderueshëm”.⁴

Periudha përfundimtare: I konsiderueshëm

Hulumtuesi MRP monitoroi institucione të ndryshme shtetërore gjatë vitit 2018⁵ në lidhje me zbatimin e veprimeve të fundit - ofrimin e informacionit në kohë reale për të verifikuar statusin e aplikimit; dhe përmirësimin e kapaciteteve të monitorimit të Ministrisë. Si rezultat, u konstatua se Komisioneri i Prokurimit Publik ndërmori kontrolle bazuar në VKM për licencimin profesional, me kërkesë dhe/ose në bazë të ankesave të palëve të ndryshme të përfshirë në punë publike ndërtimore dhe procedura tenderi. Në të paktën dy raste, Komisioneri ka marrë një vendim.⁶ Megjithatë, nuk ka informacion publik për atë që është arritur me qëllim shkëmbimin e informacionit në kohë reale dhe për përmirësimin e kapaciteteve të monitorimit. Prandaj, zbatimi nuk mund të konsiderohet si i përfunduar.

A mundësoi qeverisje të hapur?

Aksesi tek informacioni: Nuk ndryshoi

Pjesëmarrja qytetare: Nuk ndryshoi

Llogaridhënia publike: Nuk ndryshoi

Ky angazhim nuk ka lidhje me PQH dhe, për nga mënyra e zbatimit, nuk ka rezultuar në ndryshim të punës së qeverisë në lidhje me vlerat PQH.

Hapat e mëtejshëm

Në kohën kur po përgatitej ky raport, Shqipëria nuk e kishte publikuar ende planin e katërt të veprimit, kështu që nuk është e qartë nëse ky angazhim do të vazhdojë edhe në planin tjetër. Çdo angazhim që lidhet me mbikëqyrjen e ofruesve të shërbimeve ndërtimore duhet të synojë rritjen e transparencës dhe krijimin e kushteve për rritjen e llogaridhënies publike.

¹ VKM Nr. 943, http://www.qbz.gov.al/botime/fletore_zyrtare/2016/PDF-2016/262-2016.pdf

² The E-Albania portal, <https://e-albania.al/sherbimi.aspx?kodi=11138>

³ Njoftim i Ministrisë së Zhvillimit Urban, <http://ns3036873.ip-149-202-208.eu/websites/ministria.turizmit/sq/licencat-profesionale-ne-fushen-e-studimit-e-projektimit-dhe-mbikqyrje-e-kolaudimit-te-punimeve-te-ndertimit/>

⁴ Raporti i Progresit të Shqipërisë nga MRP 2016/2017, <https://www.opengovpartnership.org/commitment/17-integrated-electronic-system-professional-licensing-of-individuals-and-legal-entities>

⁵ Institucionet e monitoruara ishin Ministria e Zhvillimit Urban, Ministria e Turizmit dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë.

⁶ Komisioneri i Prokurimit Publik, Vendim 131/2018 i 13 marsit 2018,

http://www.kpp.gov.al/ppadv/DF_DocumentViewer.aspx?id=f1f9ec3f-33ff-449b-9717-595dbefed3e3; dhe Vendimi 658/2018 i 4 tetor 2018, http://www.kpp.gov.al/ppadv/DF_DocumentViewer.aspx?id=46881f3f-23a1-4d8a-9081-8b3e735cfb07

Shënime për metodologjinë

Raporti përfundimtar bazohet në punë kërkimore dhe intervista me aktorë qeveritarë dhe jo-qeveritarë. Raporti MRP mbështetet në gjetjet e raportit të vetë-vlerësimit të qeverisë, vlerësimeve të tjera të progresit të hartuara nga shoqëria civile, sektori privat, apo organizatat ndërkombëtare dhe në raportet e mëparshme të progresit të MRP.

Për përgatitjen e këtij raporti, Hulamtuesi MRP bëri monitorim të vazhdueshëm të zbatimit të angazhimeve gjatë gjithë periudhës së zbatimit, punë kërkimore dhe analiza të burimeve dytësore (p.sh., raportime të medias dhe burimeve të ndryshme, të dhëna dhe burime të tjera analitike) si dhe intervista me aktorët kryesorë. Në mungesë të një raporti vetë-vlerësimi të qeverisë dhe duke pasur parasysh mungesën e pikave të kontaktit të PQH në institucionet përgjegjëse që nga viti 2017 deri në fund të 2018, Hulamtuesi MRP realizoi një sërë intervistash të tjera me nëpunës civilë dhe zyrtarë të qeverisë në institucione të ndryshme shtetërore dhe me aktorë të tjerë të informuar për të evidentuar progresin e arritur.

Gjergji Vurmo ka një përvojë pune mbi 15-vjeçare me organizatat e sektorit të tretë në fushat e qeverisjes së mirë, integritetit evropian dhe zhvillimit të shoqërisë civile,. Ai është edhe Drejtor Programi në Institutin për Demokraci dhe Ndërmjetësim, një organizatë joqeveritare me qendër në Tiranë.

Partneriteti i Qeverisë së Hapur (PQH) synon të sigurojë angazhime konkrete të qeverive me qëllim promovimin e transparencës, fuqizimin e qytetarëve, luftën kundër korrupsionit dhe shfrytëzimin e teknologjive të reja për forcimin e qeverisjes. Mekanizmi i Raportimit të Pavarur (MRP) vlerëson hartimin dhe zbatimin e planeve kombëtare të veprimit për të nxitur dialogun mes aktorëve kryesorë dhe për të përmirësuar kërkesën e llogarisë.

